




Регионална платформа на западен Балкан за застапување
на слободата на медиумите и за заштита на новинарите
Western Balkan's Regional Platform for Advocating
Media Freedom and Journalists' Safety

Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve në Maqedoni



Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve në Maqedoni

**Autorë:
Besim Nebiu,
Naser Selmani,
Dragan Sekulovski,
Deniz Sulejman
Shtator 2018**

Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave
dhe sigurinë e gazetarëve në Maqedoni

Shtator 2018

Publikues:

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë



Gradski - Xid blok 13, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Tel: +389 (0) 2 3298-139

Faks: +389 (0) 2 3116-447

www.znm.org.mk

Autorë:

Besim Nebiu, Naser Selmani, Dragan Sekulovski, Deniz Sulejman

Përktheu:

Benjamin Arifi

Ky publikim është hartuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetëm e Shoqatës së pavarur të gazetarëve të Serbisë dhe të autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Qëllime të projektit dhe metodologjia e hulumtimit	7
Rezyme	8
A. Mbrojtje juridike e lirisë së mediave	17
A.1. A siguron legjislativi vendor garanci për lirinë e mediave, dhe a zbatohen ato në mënyrë efektive në praktikë?	18
A.2. A kanë efekt frikësimi tek gazetarët, ligjet për shpifje?	22
A.3. A ekziston mbrojtje e mjaftueshme juridike për pluralizmin politik në media, para dhe pas fushatave zgjedhore?	23
A.4. A ka garanci ligjore për veprimtarinë e gazetarisë dhe zbatohet ky ligji?	24
A.5. Sa është niveli i mbrojtjes juridike të burimeve të gazetarëve?	26
A.6. Sa është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje deri tek informatat me karakter publik? ..	27
B. Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës	29
B.1. A keqpërdoret pozita ekonomike e gazetarëve me qëllim që të kufizohet liria e tyre?	30
B.2. Sa është niveli i pavarësisë redaktuese nga pronarët e mediave dhe organet udhëheqëse?	32
B.3. Cili është niveli i pavarësisë redaktoriale të gazetarëve në servis publik?	33
B.4. Cili është niveli i pavarësisë redaktoriale të gazetarëve në sektorin jofitimprurës?	33
B.5. Sa kanë liri gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?	34
C. Siguria e gazetarëve dhe statistika e mosdëshkimit	37
C.1.1. Sulme ndaj gazetarëve dhe kërcënime të tjera	39
C.1.2. Vrasje të gazetarëve dhe ngjarje gjatë 15-20 viteve të fundit	40
C.1.3. Presion ndaj mediave, esnafëve dhe organizatave mediatike	41
C.2.1. A marrin politikanët dhe institucionet shtetërore masa të veçanta me të cilat mbrohen gazetarët?	41
C.2.2. A ekzistojnë mekanizma të veçanta nëpërmjet të cilave ndiqen sulmet ndaj gazetarëve?	43
C.2.3. A i njohin institucionet qeveritare sulmet ndaj gazetarëve?	43
C.2.4. A ekzistojnë dokumente në kuadër të policisë ose ushtrisë, që shërbejnë si udhëzues në raste kur janë cenuar të drejtat e gazetarëve?	44
C.2.5. A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat dhe esnafet e gazetarëve, lidhur me sigurinë e gazetarëve?	44
C.2.6. Cili është rasti i fundit i përgjimit jolegal dhe ndjekjes së gazetarëve, dhe si institucionet shtetërore ballafaqohen me këtë gjë?	44
C.3. Si ballafaqohet gjyqësori me çështjet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj gazetarëve?	45
C.3.1. A ekzistojnë institucione specifike të cilat merren me hetime kur cenohen të drejtat e gazetarëve?	46
C.3.2. A janë efektive hetimet e rasteve të frikësimit ose sulmit ndaj gazetarëve?	46

Qëllime të projektit dhe metodologjia e hulumtimit

Ky raport paraqet rezultatet e studimit të kryer në kuadër të projektit “Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Avokimin e Lirisë së Medias dhe Sigurinë e Gazetarëve”, e cila zbatohet nga shoqatat kombëtare gazetareske nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Serbia dhe sindikata e mediave nga Mali i Zi. Ky raport paraqet vazhdimësi e studimit bazik të legjislacionit, gjendjes socio-ekonomike dhe politike lidhur me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve, të cilët identifikuan sfidat kryesore dhe rekomandime për shoqatat e gazetarëve dhe aktorët tjerë të mediave⁴. Qëllimi kryesor i këtij studimi të tretë ishte identifikimi i zhvillimeve të reja dhe krahasimi i gjendjes aktuale të lirisë dhe sigurisë së medias me situatën e konstatuar në vitet 2016 dhe 2017.

Hulumtimin e bënë Besim Nebiu, Naser Selmani, Dragan Sekulovski dhe Deniz Sulejman, bazuar në një Metodologji të përbashkët për të gjitha pesë vendet. Ishin të përdorura metoda të ndryshme cilësore dhe sasore për grumbullimin dhe analizën e të dhënave:

- Analiza cilësore e dokumenteve (ACD) e studimeve hulumtuese dhe analizave të prodhuara nga organizata të tjera hulumtuese, akademikë, OJQ, hulumtues individualë etj.; e dokumenteve zyrtare të prodhuara nga institucionet publike (aktet ligjore, nënligjore, strategjitë, raportet vjetore, procesverbalet nga mbledhjet, njoftimet për shtyp) dhe e mbulimit mediatik (tekste, artikuj, raportet e lajmeve dhe materiale të tjera të publikuara).
- Intervistat cilësore me 19 individë (gazetarë, juristë, ekspertë të mediave, përfaqësues të institucioneve publike ose OJQ)
- Të dhëna zyrtare statistikore të kërkuara nga institucionet publike, duke përfshirë këtu edhe komunat ose të mbledhura nga faqet e internetit në dispozicion ose nga burime të tjera të botuara.

Kjo rezime i përmban gjetjet dhe konkluzionet kryesore nga hulumtimi, ndërsa i përfshinë edhe rekomandimet kryesore për politikën që duhet të zbatohen.

Rezime

A. Mbrojtje juridike e lirisë së mediave

Gjendja e lirisë së mediave në vitin 2018 në Maqedoni, shënon një përmirësim të vogël, por ende mungojnë reforma serioze në sistem të cilat më pas do të krijojnë një ambient të volitshëm për zhvillim të papenguar të mediave dhe gazetarisë profesionale.

Kushtetuta e Maqedonisë garanton lirinë e mediave, por garancitë e tilla nuk përcillen edhe në ligjet dhe aktet nënligjore. Por, problem shtesë është edhe moszbatimi ose zbatimi selektiv.

Qeveria e re e formuar në qershor të vitit 2017, premtoi që do ta përmirësoje gjendjen e lirisë së shprehjes, nëpërmjet përmirësimit të rregullativës ligjore e cila rregullon punën e mediave. Asnjë prej projekteve të premtuara ligjore nuk janë miratuar në Parlament. Vetëm ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për shërbime audio dhe audiovizuale janë në një fazë më të avancuar, por këto ndryshime janë të bllokuara në Parlament nga opozita, e cila ka dorëzuar mbi 60 amendamente dhe po e zvarritë debatin në Komisionin për Transport dhe Lidhje.

Ligjet e tjera, siç është Ligji për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, Ligji për qasje deri tek informatat me karakter publik, si dhe konstatimi i një modeli për subvencionim të mediave të shkruara, ende janë në fazë fillestare. Kryesisht, me këto ndryshime, Qeveria pohon se synon që të harmonizojë Ligjin për shpifje, me standardet evropiane dhe ta lehtësojë qasjen deri tek informatat me karakter publik.

Ndryshimet në Ligjin për SHAA, kryesisht janë të harmonizuara me shoqërinë mediatike dhe gazetareske, megjithatë, ende ka dallime rreth modelit të financimit të Radio Televizionit të Maqedonisë. Organizata mediatike dhe gazetareske, insistojnë që 1 për qind nga buxheti i shtetit, që është rreth 30 milion euro, të shkojë për financimin e servisit publik. Qeveria e refuzon këtë propozim me arsyetimin se nuk ka para, ndërsa ndërkohë e ndryshoi modelin e financimit të RTVM-së, duke prezantuar këtë masë si të përkohshme derisa nuk bëhen ndryshimet në Ligjin për Media, ku është vendosur një zgjidhje kompromisi për rritje graduale të përqindjes së buxhetit për financim të RTMV-së, që në vitin 2020, duhet të arrijë 1 përqindëshin e buxhetit qendror të shtetit. **(Pjesa A.1)**

1 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve 2016 – Maqedoni, (Shkup: SHGM, 2016) <http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2017/01/Full-MK-ENG-Digital.pdf>

Servisi publik, RTVM, nuk ka një autonomi institucionale për shkak të bordeve drejtuese të politizuara dhe për shkak të mungesës së një burimi të qëndrueshëm financiar. Qeveria në vitin 2017, e përgjysmoi buxhetin e RTVM-së, duke e prezantuar si një masë të përkohshme, ndërsa bordet drejtuese të kësaj shtëpie mediatike, vazhdojnë të jenë të lidhura me pushtetin e kaluar.

Gjatë fazës së përpilimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për SHAAV, Qeveria tentoi që standardet e gazetarisë, ti rregullojë me ligj. Por, pas një presioni nga shoqëria gazetareske, ajo hoqi dorë nga qëllimi që ti sanksionojë me ligj standardet etike gjatë raportimit të mediave.

Ekziston një tendencë e përmirësimit të punës së Agjencisë së Mediave e cila gjatë vitit të fundit është shumë më aktive dhe tashmë qëndrimet e saj lidhur me problemet në media, përafrohen me ato të organizatave profesionale mediatike, sidomos kur bëhet fjala për diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes. Këtë trend pozitiv të punës së rregullatorit mediatik, e ka vërejtur edhe OSBE-ja dhe e ka shënuar në raportin e fundit për raportimin e mediave në Maqedoni, lidhur me fushatën zgjedhore gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Mendim të ngjashëm për punën e rregullatorit, kanë edhe ekspertët mediatik. **(Pjesa A.2)**

Sa i përket raportimit të mediave gjatë fushatës për zgjedhjet lokale të vitit 2017, që u zhvilluan në tetor të 2017-ës, Agjencia e mediave ngriti 14 kallëzime kundërvajtëse kundër disa mediave për shkelje të ndryshme të Kodit Zgjedhor. Por, shumica e kallëzimeve ishin hedhur poshtë nga gjykata, ndërsa në tre raste, gjykata kishte shqiptuar dënime më të ulëta se sa ato që janë parashikuar me ligj.

Me vendim të Qeverisë, ishte ndaluar reklamimi Qeveritar, që e kishte vendosur pushteti i kaluar, dhe që këtë lloj të reklamimit në media e shfrytëzonte si instrument për ndikim në politikën redaktuese të mediave. Edhe pse Qeveria i shfuqizoi reklammat, gjatë verës së vitit 2018, në marrëveshje me opozitën, vendosi një lloj tjetër të financimit të propagandës politike në media, që do të paguhet me para të popullit.

Në plotësimet e Kodit zgjedhor, u vendos mundësia që një pjesë e parave publike për financimin e partive politike, të shfrytëzohen edhe për pagesë të propagandës politike në media, gjatë fushatës zgjedhore, ndërsa Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve tashmë morri edhe detyrën që të monitorojë raportimin e mediave online gjatë fushatës zgjedhore. Ky gjest u kritikua nga shoqëria e gazetarëve që e cilësoi këtë gjest si kthim të reklamave dhe vazhdim të lidhjeve klienteliste mes partive politike dhe pronarëve të mediave, dhe si tentativë për të penguar qasjen deri tek interneti.

Përkundër faktit që Qeveria i ndaloi reklammat qeveritare, komunat në Maqedoni vazhduan me shpenzimin e parave publike për financimin e mediave lokale dhe rajonale. Hulumtimi i SHGM-së tregoi se dy e treta e komunave në vitin 2018, kanë harxhuar ose kanë qëllim të harxhojnë rreth gjysmë milion euro për reklamim dhe angazhim të gazetarëve me kontrata autoriale. **(Pjesa A.3)**

Qeveria nuk e harmonizoi Ligjin për përgjegjësi penale për shpifje dhe fyerje me trendet e reja evropiane, edhe pse një gjë e tillë ishte e paraparë në planin reformator 18. Shpifja është dekriminalizuar në vitin 2012, dhe prej atëherë numri i padive kundër gazetarëve është ulur në mënyrë drastike. Asokohe në Gjykatën Penale kishte mbi 300 padi për shpifje kundër gazetarëve, ndërsa këtë vit ka vetëm rreth 30 lëndë aktive. Gazetarët e intervistuar vlerësojnë se pushtetarët gjithnjë e më pak përdorin padinë për shpifje si presion ndaj gazetarisë kritike. Përrjashtim nga ky fakt bëjnë vetëm përfaqësuesit e partisë në qeveri, Bashkimi Demokratik për Integritet, që ende ngrisin padi kundër mediave kritike në gjuhën shqipe. Shembulli më drastik ishte kur Gjykata Civile, e dënoi kryeredaktorin e gazetës "Lajm" Isen Saliu, me 20 mijë euro kompensim për dëm jomaterial për cenim të nderit dhe imazhit të liderit të BDI-së Ali Ahmeti. Gjykata e Apelit megjithatë e ktheu padinë në rishqyrtim.

Gjykata civile në Shkup, refuzon ta vejë në përdorim Ligjin për përgjegjësi civile në lëndë kundër mediave online, duke u thirrur në ligj tjetër se ata nuk janë të definuara si media. Praktikën e tillë e legalizoi edhe Gjykata e Apelit në Shkup, ndërsa gjykatat e tjera të apelit që i procesojnë paditë për shpifje ndaj mediave online, kanë një praktikë krejtësisht tjetër. Sjelljen e gjykatave të Shkupit SHGM-ja e cilësoi si politikisht të motivuar, në mënyrë që t'i sigurojë alibi Qeverisë për të vendosur legjislacion më rigoroz për mediat online. SHGM-ja ka dërguar kërkesë deri tek Gjykata Supreme për të harmonizuar praktikën gjyqësore, por deri më tani, kjo gjykatë nuk është prononcuar. **(Pjesa A.4)**

Në Maqedoni, profesioni i gazetarisë nuk licencohet, por në Ligjin për Media, kishte një tentativë për përkufizimin termit gazetar. Këtë tentativë të Qeverisë, shoqëria gazetareske e refuzoi, dhe kërkoi fshirjen e tërësishme të definicionit.

Burimet e informacioneve në Maqedoni, janë të mbrojtura me ligj, megjithatë praktika tregon diçka tjetër. Gazetari Tomisllav Kezharovski në vitin 2013 ishte dënuar për zbulimin e identitetit të një dëshmitari të mbrojtur, ndërsa arsyeja e vetme për përndjekjen e tij ishte refuzimi që e kishte bërë për ta zbuluar burimin e informatave. **(Pjesa A.5)**

E drejta e qasjes së lirë deri tek informatat me karakter publik, në legjislativin e Maqedonisë është e garantuar, por në këtë ligj ka shumë baza me të cilat institucionet mund ti refuzojnë kërkesat për qasje deri tek informatat, ndërsa për gazetarët, afati prej 30 ditësh për përgjigje është tejet i gjatë. Nga ana tjetër, institucionet vazhdojnë të mos jenë transparent ndaj gazetarëve dhe vendosin që ti injorojnë pyetjet e tyre, ose të japin informata gjysmake. **(Pjesa A.6)**

B. Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

Hulumtimet e zhvilluara në Maqedoni gjatë vitit të fundit, dëshmojnë se ekzistojnë kufizime serioze të lirive të gazetarëve. Perceptimi i tillë buron nga anketat e me gazetarët, që janë zhvilluar nga organizata media-tike dhe nga intervistat me ekspertët mediatik.

Shumë shpesh, gazetarët mund të humbin punën pasi nuk kanë mbrojtje juridike nga institucionet, dhe nuk i njohin mirë të drejtat e tyre. Edhe më tej, rrogat janë të ulëta dhe nën mesataren e të ardhurave mujore në shtet, ndërsa gjithnjë e më pak gazetarë kanë një vend të sigurtë pune, me marrëveshje konstante pune, dhe me kontribute të paguara sociale, ose që gëzojnë benefite të punëtorit.

Rroga mesatare neto e gazetarëve, është 18.800, që është për rreth 30% më pak se sa rroga mesatare e paguar në shtet gjatë vitit 2018. Gjysma e tyre nuk kanë marrëveshje për punësim në afat të pacaktuar, ndërsa një pjesë e vogël janë të angazhuar me marrëveshje autoriale. Sipas hulumtimit të fundit të Sindikatit të gazetarëve, shumicës së gazetarëve iu vonohen rrogat. Ekzistojnë gazetarë jashtë Shkupit që punojnë edhe për rroga më të vogla se 12 mijë denarë.

Për shkak të kësaj pozite të palakmueshme, gazetarët janë pre e lehtë e presionit në redaksitë e tyre dhe fillojnë të praktikojnë vetë-censurimin. Ata nuk kërkojnë mbrojtje pasi nuk kanë besim në institucionet ose pasi rrezikojnë që ta humbin punën. Prandaj edhe nuk ekziston asnjë vendim gjyqësor për mobing në punë ndaj një gazetari. Një prej indikatorëve për ekzistencën e presionit në redaksi, është fakti se shumica e gazetarëve të anketuar insistojnë që të mbeten anonim, për shkak të frikës se mund të kenë pasoja në punë. **(Pjesa B.1)**

Mediat private në ueb faqet e tyre nuk publikojnë akte të brendshme me të cilat e garantojnë pavarësinë e kolegjiut redaktues, nga menaxhmenti në media. Shembulli më eklatant i përzjerjes së menaxhmentit të medias në lirinë e gazetarëve, është një drejtor i një televizioni privat, kombëtar, që publikisht pranoi se ka dhënë urdhër deri tek kryeredaktori që të mos i publikojë deklaratat e kryetarit të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë. **(Pjesa B.2)**

Gjendja e ngjashme paraqitet edhe me gazetaret e RTMV-së. Këtu, për shkak të politizimit të bordit drejtues dhe pozitës së pavolitshme financiare, ata janë pre e presioneve nëpërmjet masave disiplinore, dënimeve me para, ndryshimeve të vendit të punës dhe ngjashëm. Nga ana tjetër, gazetaret e dëgjueshëm favorizohen me shpërblime në para dhe me udhëtime jashtë vendit.

Profesionistët marginalizohen ose ju japin tema anësore që duhet ti përpunojnë. Kjo reflektohet në përmbajtjet e programeve informative, thotë një gazetar nga RTVM-ja, i cili insiston që të mbetet anonim. **(Pjesa B.3)**

Presioni ndaj këtyre mediave është zvogëluar dukshëm, krahasuar me presionin që ishte i pranishëm gjatë viteve të fundit, kur gazetaret dhe redaktorët e këtyre mediave, shpesh ishin pre e diskreditimit publik në bazë personale, dhe ndaj tyre përdorej gjuhë e urrejtjes, për shkak të kritikave të tyre publike ndaj pushtetit dhe biznesmenëve të afërt me Qeverinë. **(Pjesa B.4)**

Të ballafaquar me pozitën e tillë të palakmueshme, gazetaret e punësuar në mediat private dhe në sektorin publik, shumë rrallë përpunojnë tema të ndjeshme, dhe kryesisht mbulojnë ngjarje ditore politike. Tani janë shpeshuar debatet në mediat private, por në opinion ekziston perceptimi se defilojnë ekspertët e njëjtë, të afërt me qendra të caktuara fuqie ekonomike ose politike. **(Pjesa B.5)**

C. Siguria e gazetarëve dhe statistika e mosndëshkimit

Numri i sulmeve kundër gazetarëve është ulur, por në institucione ka prani të fortë të politikës së mosndëshkimit të dhunës ndaj gazetarëve. Gjatë vitit të fundit, SHGM-ja ka regjistruar gjashtë sulme ndaj gazetarëve, një sulm fizik, një kërcënim me vdekje, dy arrestime arbitrare nga policia, një rast të shkatërrimit të pronës së gazetarit dhe një rast kur një fotoreporter është penguar që të raportojë nga një ngjarje publike. Krahasuar me vitin paraprak kur ishin regjistruar 18 raste të sulmit ndaj gazetarëve, numri i rasteve është zvogëluar për tre herë.

Ajo që është pozitive është se sivjet institucionet e ndërprejnë politikën e mosndëshkimit për dhunë ndaj gazetarëve, që kishte zgjatur thuajse dhjetë vite. Gjykatat e Maqedonisë në këtë periudhë, sollën dy vendime gjyqësore, me të cilat, sulmuesit e gazetarëve u dënuan me dënime me burg dhe me para. **(Pjesa C.1)**

Ulja e presionit ndaj gazetarëve si rezultat i ndryshimit të ambientit politik, është vërejtur edhe nga Komisioni Evropian, gjatë raportit për përparimin e Maqedonisë në vitin 2018². Megjithatë, Komisioni vlerëson se nuk mjafton vetëm regjistrimi i sulmeve dhe dënimi i të njëjtëve, dhe se Prokurori publike seriozisht duhet të hetojë dhe t'i thirrë në përgjegjësi dhunuesit.

Gjykata Penale në Shkup, në shtator të këtij viti, e dënoi me gjashtë muaj burg Matija Kanxhikovin, i cili gjatë shkurtit të vitit të kaluar, pas protestës së Lëvizjes “Për Maqedoni të përbashkët”, kundër formimit të Qeverisë së re, i sulmoi fizikisht, gazetarin e portalit A1ON Aleksandar Todevski, dhe kameramanin Vladimir Zhellçevski. Një muaj më pas, policia e zbardhi rastin dhe ngriti kallëzim penal kundër Kaninkovit³, ndërsa në shtator të këtij viti, gjykata e dënoi autorin me burg⁴. Mbrojtja ka paralajmëruar ankesë ndaj vendimit, dhe tani pritet përgjigje nga Gjykata e Apelit në Shkup.

2 Komisioni Evropian, Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2qJP0Kv>, qasur më 5 shtator të vitit 2018.

3 SHGM, „MPB ta zbardhë rastin e sulmit ndaj gazetarëve të A1ON”, Shkup, viti 2018, <http://znm.org.mk/?p=3119>

4 SHGM, “Përsëritje dënimit me burg të sulmuesit të gazetarëve të A1ON”, Shkup, viti 2018, <http://znm.org.mk/?p=4663>

Institucionet kanë zhvilluar procedurë efikase edhe në rastin e Armando Brahos nga Struga, i cili në janar të këtij viti, ishte sulmuar fizikisht nga aktivistë të partisë opozitare Aleanca për Shqiptarët e Zijadin Selës, me qëllim që ta pengojnë në raportimin e tij nga një tubim parazgjedhor i kësaj partie⁵. Policia i identifikoi shpejtë sulmuesit dhe ngriti kallëzim para Gjykatës Kundërveajtëse në Strugë. Pas gjashtë muajsh, gjykata i shpalli fajtorë dhe i dënoi me para. Këtë vendim, mbrojtja e ka ankimuar.

Ajo që më së shumti shqetëson sa i përket sigurisë së gazetarëve në vitin 2018, është fakti se policia në mënyrë arbitrare, arrestoi disa gazetarë dhe kështu i pengoi në kryerjen e detyrave të tyre profesionale. **(Pjesa C.2)**

Incidenti i parë më serioz me gazetarë, i shkaktuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndodhi në nëntor të vitit 2017, kur pjesëtarë të policisë, e arrestuan dhe dërguan në stacion policor, kameramanin e Televizionit 21 Ibrahim Mahmuti, dhe një fotoreporter nga Kosova me emrin Blerim Uka⁶. Që të dytë u mbajtën në stacion policor për më shumë se gjashtë orë, me akuzën se gjatë shpalosjes së verdiktit për rastin kontrovers “Kumanova”, e kanë filmuar gjykatësen⁷. Të dy gazetarët u liruan pas intervenimit të faktorit ndërkombëtar, ndërsa një përfaqësues i OSBE-së bisedoi me personat përgjegjës të stacionit policor. Pas këtij incidenti, policia nuk ngriti asnjë procedurë kundër pjesëtarëve të saj për shkak të arrestimit të gazetarëve.

Një incident më i lehtë me gazetar, i shkaktuar nga policia, ka ndodhur në qershor të këtij viti, gjatë protestave kundër Marrëveshjes me Greqinë para Kuvendit, kur ishte arrestuar gazetari i portalit “Infomaks”, Borisllav Stoilkoviq, me arsyetimin se i ka filmuar gazetarët në fytyrë, dhe ka refuzuar që të legjitimohet⁸.

Fakti që shqetëson është se një pjesë e konsiderueshme e sulmeve që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit, nuk janë zbardhur fare, ose procedurat e hetimit nuk janë zhvilluar si duhet. Kryesia e re e MPB-së ankohet se për disa raste të caktuara, nuk ka gjasa që të gjenden autorët, pasi që kryesia e mëparshme i ka zhvilluar hetimet në mënyrë joprofesionale, ndërsa në disa raste mungojnë edhe prova⁹. Prej 59 sulmeve ndaj gazetarëve që kanë ndodhur gjatë pesë viteve të fundit, policia ka zbardhur tërësisht, vetëm shtatë raste, dhe ka ngritur kallëzime penale kundër autorëve. **(Pjesa C.3)**

Policia e ka zbuluar sulmuesin e pronarit të portalit “Dokaz”, Marjan Stamenkovski, i cili në vitin 2015, në qendër të Shkupit, ishte sulmuar fizikisht, dhe kishte marrë lëndime të rënda trupore. Është zbuluar edhe sulmuesi i ekipit të portalit “A1ON” që ishte sulmuar gjatë protestave të Lëvizjes “Për Maqedoni të përbashkët”, në qendër të Shkupit.

Sipas raportit, policia deri më tani nuk ka arritur të zgjidhë tërësisht 13 lëndë për sulme ndaj gazetarëve, që kanë të bëjnë me sulme fizike dhe kërcënime, dhe shkatërrim të pronës. Pa u zgjidhur mbeten edhe sulmet fizike dhe shkatërrimi i pajisjeve të disa gazetarëve nga ana e protestuesve në protestat e Lëvizjes “Për Maqedoni të përbashkët”, të cilët më 27 prill, hynë me dhunë në Parlament për ta penguar formimin e Qeverisë së re. Policia nuk arriti ti zbulojë as autorët që në vitin 2015, ia hodhën flakën xhipit të gazetarit Branko Triçkovski.

Për tetë sulme, policia ka mbaruar hetimin, dhe ka dorëzuar kërkesë për ngritjen e procedurave kundërvajtësve, prej të cilave, katër kanë të bëjnë me sulme fizike, në dy raste gazetarëve u janë shkaktuar lëndime të dukshme trupore. Këto raste të rënda trajtohen sikurse rastet e sulmeve të tjera kur gazetarët kanë marrë vetëm shpulla, ose kur janë kërcënuar se do të sulmohen fizikisht.

Policia nuk e ka mbaruar punën deri në fund as për tetë raste të tjera, kur pas mbarimit të hetimit, në vend se të ngritën kallëzime adekuate, ka dorëzuar vetëm

5 SHGM, “Dënojme sulmin ndaj gazetarit në Strugë”, Shkup, viti 2018, <http://znm.org.mk/?p=4196>

6 SHGM, “SHGM e dënon arrestimin e gazetarëve nga ana e policisë”, Shkup, viti 2017, <http://znm.org.mk/?p=3866>.

7 SHGM, “SHGM e dënon arrestimin e gazetarëve nga ana e policisë”, Shkup, viti 2017, <http://znm.org.mk/?p=3866>.

8 Press24, “Video: Arrestohet një gazetar gjatë protestave të djeshme – policia e zvarriti deri te furgoni”, Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2NvoUs5> qasur më 24 korrik të vitit 2018.

9 Toçka, “Spasovski: 15 raste të sulmeve ndaj gazetarëve, qëllimisht nuk është reaguar në kohë”, Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2QcXx4F> qasur më 28 shtator të vitit 2018.

njoftime deri te Prokuroria Publike. Kjo mund të trajtohet si tentativë e policisë për të anashkuar lëndët, në mënyrë që të zvarriten në labirintet e prokurorisë.

I tillë është edhe rasti i një polici i cili në vitin 2016, i cili gjatë protestave kundër faljes së funksionarëve të lartë të VMRO DPMNE-së, të akuzuar për krime, para Zyrës së Presidentit, e ka rrahur një gazetar me shkop policor. Në mënyrë shtesë, është vërtetuar se polici i ka tejkualuar autorizimet e tij, por në vend se të ngritët procedurë kundër tij, policia vetëm ka dorëzuar njoftim deri tek Prokuroria, e cila deri më tani, nuk ka bërë asgjë lidhur me këtë lëndë.

Shtatë raste, policia i llogarit si të zgjidhura, pasi vetëm u ka sugjeruar gazetarëve të dëmtuar që ti mbrojnë të drejtat e tyre nëpërmjet padive private. Në raport nuk ka të dhëna nëse policia i ka identifikuar sulmuesit dhe ka siguruar prova, që më pas i ka vënë në dispozicion të viktimave, që të mund të zhvillojnë procedurën gjyqësore në mënyrë efektive.

Në dy lëndë, në pamundësi për ti gjetur autorët, MPB ka ngritur kallëzime penale kundër personave të panjohur, ndërsa dy procedura të tjera i ka mbyllur, pasi ka vlerësuar se nuk ka elemente të mjaftueshme për nisjen e hetimit.

Në të dy lëndët, në pamundësi për ti gjetur autorët, MPB ka ngritur kallëzime penale kundër personave të panjohur. Rasti i tillë është me sulmin ndaj gazetarit në Ohër, i cili është sulmuar nga disa persona të panjohur, me shufra hekuri, që i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore.

Ndonjëherë, policia i zgjidhë kërcënimet, ofendimet ndaj gazetarëve, vetëm me vërejtje gojore ose me shkrim ndaj sulmuesit. Në këtë mënyrë, ajo vlerëson se ka zgjidhur dhjetë lëndë të sulmeve verbale dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Vetëm me paralajmërim, ka kaluar edhe personi që në vitin 2015, për shkak të qëndrimeve kritike të gazetarit Borjan Jovanovski, e ka përzënë nda një restorant, dhe e ka kërcënuar me sulm fizik. Vetëm vërejtje gojore ka marrë edhe sigurimi privat në Qendrën Tregtare në Shtip, i cili në vitin 2017, e ka penguar ekipin e televizionit 24 që të filmojë punimet ndërtimore në qendër, dhe ia ka dëmtuar kamerën.

Në Maqedoni, nuk ka mekanizma të veçanta për ndjekjen dhe raportimin mbi sulmet ndaj gazetarëve, dhe për kërcënimet ndaj tyre. Në bazë të raporteve nga MPB-ja dhe Prokuroria, vërehet një trend negativ i zhvillimit të hetimeve për sulm ndaj gazetarëve. Policia nga njëra anë pohon se ka zgjidhur një numër të madh rastesh, dhe ato i ka dorëzuar në prokurori, ndërsa prokuroria pohon se policia nuk i ka identifikuar sulmuesit dhe kështu nuk ka siguruar prova të mjaftueshme për zhvillim më efikas të procedurave.

Në Maqedoni, asnjë institucion nuk mban llogari ose regjistër të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Përveç kësaj, me përjashtim të policisë, prokuroria dhe gjyqësori kryesisht janë të mbuluara nga aspekti i dhënies së informacioneve për lëndët që kanë të bëjnë me sulme ndaj gazetarëve.

Qeveria në mënyrë deklarative i dënon të gjithë incidentet dhe sulmet ndaj gazetarëve¹⁰. Kryeministri Zoran Zaev dhe përfaqësues të tjerë qeveritar, rregullisht i dënojnë sulmet ndaj gazetarëve dhe iu bëjnë thirrje organeve të përndjekjes që ti hetojnë rastet dhe ti dënojnë sulmuesit.

Deri më tani, as policia e as ushtria, nuk kanë miratuar dokumente të brendshme me të cilat i mësojnë pjesëtarët e tyre se si të sillen me gazetarët. Këto institucionet nuk kanë rregullore që ndalojnë kërcënimet, frikësimet ose sulmet ndaj gazetarëve.

Qeveria e re në Maqedoni, tregoi një gatishmëri më të madhe për të bashkëpunuar me Shoqatën e Gazetarëve, për të zbardhur rastet e sulmeve ndaj gazetarëve. MPB ja nënshkroi memorandum me SHGM-në gjatë vitit 2017, me të cilin parashikohet organizimi i aktiviteteve për ndërprerje të politikës së mosndëshkimit për sulmet ndaj gazetarëve¹¹. Dy trajnime¹² u organi-

10 Qeveria, "Reagim lidhur me kërcënimin ndaj kryetarit të SHGM-së Naser Selmani", Shkup, viti 2018, <http://vlada.mk/?q=node/14224>, qasur në shtator të vitit 2018.

11 AION, "SHGM dhe MPB nënshkruan Memorandum për bashkëpunim", Shkup, viti 2017, <https://aion.mk/archives/838401>, qasur në shtator të vitit 2018.

12 SHGM, "Ti vihet fundi politikës së mosndëshkimit, të dënohen sulmuesit", Shkup, 2018, <https://znm.org.mk/?p=4370>, qasur në shtator të vitit 2018.

zuan në Shkup¹³, dhe pesë të tjera në disa qytete më të mëdha të Maqedonisë.

Në tentativë për ta ndërprerë politikën e mosndëshkimit për dhunën ndaj gazetarëve, përfaqësues të SHGM-së gjatë muajit janar, u takuan me prokurorin publik Lubomir Jovevski¹⁴.

Në Maqedoni, hetimet e prokurorisë dhe gjyqësorit për sulmet ndaj gazetarëve, janë joefikase dhe joefektive. Për shkak të mbylljes së këtyre dy institucioneve, është e rëndë edhe që të ndiqen këto raste. Rezultatet nga raporti në Prokurori për hetimet janë tejet dekurajuese. Nga dhjetë lëndë të hapura, në katër raste prokuroria i ka refuzuar kallëzimet penale pasi sipas vlerësimit të tyre, bëhet fjalë për cenimin e sigurisë që nuk përndiqet në bazë të obligimit zyrtar.

Pesë rastet e tjera janë ende në fillim të hetimit, edhe pse njëri prej rasteve ka ndodhur prej katër viteve, ndërsa tjetri para dy viteve. Prokuroria pohon se ende po punon në vërtetimin e identitetit të sulmuesve dhe mbledhjes së provave të besueshme. Në dy lëndë, policia nuk ka vepruar në bazë të kërkesës së prokurorisë për identifikimin e sulmuesve. Vetëm në një rast, procedura hetimore është në një fazë të avancuar, ku sulmuesi është identifikuar nga policia, ndërsa prokuroria punon në konstatimin e gjendjes faktike, pas çka do të pasojë edhe vendimi prokurorial.

Në sistemin prokurorial-gjyqësor, ekzistojnë disa reparte të cilat punojnë në hetime të rasteve të përndjekjes, mbrojtjes dhe dëmshpërblimit të gazetarëve, me qëllim që të krijohet siguria e tyre, dhe të ndalohet politika e mosndëshkimit. Analiza e raporteve për mënyrën se si policia dhe prokuroria i zhvillojnë hetimet për sulme dhe kërcënime ndaj gazetarëve, konstaton se institucionet jo vetëm që nuk mund t'i dënojnë inspiruesit dhe porositësit e sulmeve, por nuk mund të dënojnë ose identifikojnë madje as ekzekutuesit e sulmeve.

Institucionet përgjegjëse për zbardhjen e sulmeve ndaj gazetarëve, asnjëherë me iniciativë të tyre nuk kanë organizuar trajnime për të punësuarit e tyre, për nevojën e mbrojtjes dhe promovimit të lirisë së shprehjes.

13 Safejournalists.net, „Trajnime me policinë për siguri më të madhe të gazetarëve gjatë protestave”, Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2CWpnPX>, qasur në shtator të vitit 2018.

14 SHGM, “Përfaqësues të SHGM-së u takuan me Prokurorin Publik”, Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/?p=4173>, qasur në shtator të vitit 2018.

A

**Mbrojtje juridike e
lirisë së mediave**

A.1. A siguron legjislativi vendor garanci për lirinë e mediave, dhe a zbatohen ato në mënyrë efikase në praktikë?

Garancitë kushtetuese¹⁵ për lirinë e mediave nuk janë shndërruar tërësisht në garanci ligjore. Rregullativa ligjore dhe nënligjore nuk janë të harmonizuara në tërësi me rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg. Mosrespektimi ose zbatimi selektiv i ligjeve, në mënyrë shtesë e përkeqëson gjendjen e lirisë së mediave. Intervenimet në kornizën ligjore që do të shqyrtohen në këtë raport kanë të bëjnë me ndryshimet e katër ligjeve: 1) Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale; 2) Ligji për të drejta të autorit; 3) Ligji për qasje deri tek informatat me karakter publike dhe 4) Kodi Zgjedhor.

Ngjashëm sikurse vitin e kaluar, liria e mediave në 12 muajt e fundit ka qenë një prej temave më të nxehta në debatin politik dhe të ekspertëve të Maqedonisë. Gjatë vitit 2018, Qeveria nëpërmjet Planit 18 u zotua që ta përmirësojë ambientin e lirisë së mediave. Në këtë Plan janë paraparë ndryshime në Ligjin për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, përgatitja e një raporti të veçantë për zbatimin e Marrëveshjes mes SHGM-së dhe MPB-së për rastet e dhunës ndaj gazetarëve, është konstatuar modeli për ndihmë të mediave të shkruara ndërsa janë planifikuar edhe ndryshime në Ligjin për themelimin e NP Radiodifuzioni i Maqedonisë¹⁶. Sa i përket planit paraprak 3-6-9 të vitit 2017, në planin 18, elemente të reja janë ndryshimet në tre ligjet e para që i përmendëm, dhe mund të konstatohet se nga plani paraprak 3-6-9 ishte plotësuar vetëm premtimi për ndalimin e reklamave në media, për çka edhe më herët ekzistonte moratorium.

A janë zhvilluar dokumentet strategjike për reforma në media në mënyrë transparente dhe në një proces gjithëpërfshirës?

Korniza themelore ligjore për mediat e Maqedonisë, përbëhet nga Ligji i Mediave¹⁷ dhe Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale (LSHAAV)¹⁸. Në periudhën që përfshin këtë raport, kishte disa intervenime në kornizën ekzistuese ligjore që ka të bëjë me mediat.

Ndryshimet në LSHAAV po përgatiten prej të ashtuquajturit Proces i Përzihos nga viti 2015 dhe 2016, kur partitë e atëhershme parlamentare u pajtuan për reforma të caktuara në sferën mediatike, pasi fusha e mediave, ishte theksuar si kritike për zhvillimin e Maqedonisë. Kjo ishte theksuar edhe në raportin e Pribesë dhe ishte pjesë e Reformave urgjente prioritare¹⁹.

Në shtator të vitit 2017, Qeveria përgatiti Propozim ndryshime dhe plotësime të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale²⁰. Bazë për tekstin e propozuar ligjor, me ndryshime dhe plotësime, ishte kërkesa për reforma në media. Në arsyetimin e propozim-ndryshimeve, theksohet se “qëllimi kryesor për ndryshimet është se kur është sjellë Ligji në vitin 2013, Qeveria dhe Kuvendi i kanë injoruar ankesat dhe vërejtjet e organizatave të gazetarëve. Përveç kësaj, nuk ishin futur rekomandimet kyçe të ekspertëve të Këshillit të Evropës dhe OSBE-së lidhur me zvogëlimin e ndikimit politik mbi mediat, servisin publik dhe rregullatorin mediatik”²¹.

15 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.

16 Faqe 14, Plani 18 i Qeverisë së RM-së.

17 Ligji për media të Republikës së Maqedonisë.

18 Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Republikës së Maqedonisë.

19 Komisioni Evropian, Reforma urgjente prioritare për ish republikën jugosllave të Maqedonisë https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf qasur më 11 korrik të vitit 2018. пристапено на 11 јули 2018 година.

20 META, “Teksti i propozim ndryshimeve”, Shkup, <https://meta.mk/wp-content/uploads/2017/09/ID-Zakon-za-AAVMU.doc> qasur më 15 gusht të vitit 2018.

21 Hyrje, faqe 1 e Propozim-ndryshimeve të LSHAAV.

Megjithatë, në debatin publik për propozim ndryshimet ligjore, SHGM kishte vërejtje për mungesë të përputhshmërisë së qëndrimeve të përfaqësuesve qeveritar, duke theksuar se në fillim të mandatit, ata kishin nënshkruar deklaratë me të cilin jepnin mbështetje për vetërregullimin, ndërsa me tekstin e propozuar për ndryshime, Qeveria shtoi dispozita (neni 61) me të cilat tentoi që në mënyrë ligjore, ti rregullojë standardet etike gjatë raportimit. Në esencë, Qeveria dëshironte të vendosë gjopa për mosrespektim të standardeve etike të gazetarisë, me çka në realitet do shfuqizohej vetërregullimi.

Një pjesë e konsiderueshme e vërejtjeve në debatin publik, kishin të bëjnë me servisin publik radiodifuziv dhe financimin e tij. Edhe pse SHGM dhe organizatat e tjera mediatike kërkuan financimi i servisit publik të bëhet me një për qind të buxhetit qendror, Qeveria në propozim ndryshimet konstatoi vetëm 0,7 për qind, që nuk do të sigurojë konsolidim dhe stabilitet financiar të servisit publik²².

Në debatin publik, SHGM prezantoi një sërë propozimesh dhe qëndrimesh lidhur me propozimet në lojë, më së shumti në pjesët që kishin të bëjnë me: a)Reformat në servisin publik(RTVM), b)rregullatorin- Agjencinë për shërbime audio dhe audiovizuale, si dhe c)obligimet ndaj radiodifuzerëve privat. Sipas propozimit final që Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë e dorëzoi për shqyrtim në Komisionin Evropian, një pjesë e vërejtjeve të SHGM-së janë pranuar ndërsa një pjesë tjetër janë refuzuar.

Kritika dhe vërejtja më e madhe e SHGM-së ka të bëjë me reformat tek Radio-Televizioni i Maqedonisë. Sipas SHGM-së, nuk mund të ketë reforma të vërteta në sferën mediaike, pa reforma serioze në servisin publik. Departizimi i organeve drejtuese dhe sigurimi i një sistemi permanent të financimit të servisit publik, janë gjëra kyçe për përfundimin e pavarësisë dhe profesionalitetit të saj.

Kritikat e SHGM-së kanë të bëjnë me ndryshimin e nenit 11 me të cilin bëhet ndryshim tek neni 48, dhe ka të bëjë me ndalesa të veçante me të cilat propozohet fshirja e fjalëve “përfaqësues në grupeve të marginalizuara”, dhe zëvendësimi i të njëjtave me “orientim seksual”. Përveç kësaj, SHGM propozoi që formulimi “bindje të tjera” në tekstin e ligjit, të fshihet dhe të zëvendësohet me fjalët “antisemitizëm dhe ksenofobi”.

Vërejtja kryesore e ligjit ekzistues për shërbime audio dhe audiovizuale, ishte rreth nenit 92, i cili përzihet në skemën programore të mediave kombëtare private, me çka imponohen obligime serioze ndaj radiodifuzerëve, lidhur me përmbajtjen e programit që do të emetohet²³.

Në momentin kur po shkruhej ky raport, Propozim-ligji për shërbime audio dhe audiovizuale është bllokuar në procedurë parlamentare, pasi sipas Qeverisë, partia opozitare VMRO DPMNE po e bllokoi sjelljen e Ligjit, nëpërmjet zvarritjes së debatit rreth amendamenteve²⁴.

A tentoi pushteti që ta kufizojë qasjen në internet dhe a kishte raste të bllokimit të përmbajtjeve mediatike në internet?

Në periudhën mes gushtit dhe shtatorit të vitit 2017 dhe gushtit të vitit 2018 për çka është ky raport, nuk kishte tentativa nga Qeveria për censurim ose filtrim të përmbajtjeve në internet. Në kuadër të debatit për reformat mediatike, debatohej në mënyrë intensive edhe për nevojën e rregullimit të mediave online, ose të internetit. Gjatë debatit prezantoheshin mendime të ndryshme për atë se a duhet apo jo të ketë regjistrim ose vetëm evidentim të mediave online. SHGM

22 Akademik, “Debat publik për propozim-ndryshimet në Ligjin për Shërbime audio dhe audiovizuale”, Shkup, 2018 <https://www.akademik.mk/javna-diskusija-za-predlog-izmenite-vo-zakonot-za-audio-i-audiovizuelni-mediumski-uslugi/> qasur më 14 qershor që vitit 2018.

23 Mediaobservatorium, “Ligji është vetëm mjet, dhe nuk është çelës për media të lira dhe profesionale”, Shkup, 2018 <http://mediaobservatorium.mk/zakonot-e-samo-alatka-a-ne-e-kluch-za-slobodni-i-profesionalni-mediumi/> qasur më 8 gusht të vitit 2018.

24 Qeveri, “MIAP Mançevski për Ligjin për LSHAAV: Apeloj për mbështetje dhe zhbllokim sa më të shpejtë të reformave në media”, Shkup, 2018 <http://vlada.mk/node/14925> qasur më 7 gusht të vitit 2018.

por edhe organizatat e tjera mediatike, përfshirë këtu edhe Këshillin e Etikës në Media, si dhe Sindikatën e Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik, janë kundër idesë për rregullimin e mediave online, pasi kjo sipas tyre, prek direkt lirinë e shprehjes dhe qasjen e lirë në internet.

A e kryen rregullatori mediatik punën e tij në mënyrë të pavarur dhe të paanshme?

Lidhur me pavarësinë e rregullatorit dhe servisit publik, gjatë vitit aktual nuk ishin sjellë ligje dhe dispozita nënligjore, që duhej ta përforcojnë pavarësinë e Agjencisë së Mediave dhe RTVM-së. Vërejtjet për varësinë e rregullatorit nga ndikimet politike që janë konstatuar në raportin paraprak, vlejné ende.

Të gjithë gazetarët dhe ekspertët e intervistuar vërtetojnë se ekziston tendencë e përmirësimit të punës së ASHAM-it. Përmirësimin e shohin pasi ka rritje të "proaktivitetit lidhur me fenomenet dhe problemet e ndryshme në sferën mediatike, si dhe koordinim dhe veprim të përbashkët me mediat profesionale kur bëhet fjalë për paraqitjen e diskriminimit dhe gjuhën e urrejtjes në media, por edhe për raportimin joprofesional"²⁵. Tamara Çausidis nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve, e vlerëson punën e ASHAM-it si "krejtësisht ndryshe nga ajo e përparmja, dhe kjo gjë vetëm vërteton se ASHAM ka punuar me direktiva partiake, dhe në këtë periudhë kohore, tenton të dëshmojë se ka ditur të punojë, por nuk ka mundur".

A ekziston praktikë e reklamimit shtetëror në media dhe a shfrytëzohet kjo metodë për ndikim mbi politikën redaktuese të mediave?

Në këtë pjesë, është vërejtur përparim gjatë vitit të kaluar. Qeveria hoqi dorë nga reklamimi në mediat private, me para shtetërore. Kjo ishte praktikë e Qeverisë së kaluar, e cila ishte kritikuar ashpër për këtë arsye,

edhe nga opinioni vendor edhe nga ai ndërkombëtar. SHGM këtë gjest e ka përshëndetur dhe vlerësuar si hap pozitiv, në drejtim të shkapitjes së lidhjeve klienteliste mes Qeverisë dhe pronarëve të mediave²⁶.

Megjithatë, përjashtim përbente reklamimi në rrjetet sociale, si dhe formulimi se "komunikimi i mëtejshëm do të zhvillohet nëpërmjet servisit publik"²⁷.

A ekzistojnë subvencione për produksion të përmbajtjeve mediatike me interes publik, dhe nëse ekzistojnë, si funksionon kjo në praktikë?

Për momentin nuk ekziston një zgjidhje sistematike për subvencionimin e përmbajtjeve mediatike me interes publik. Kah fundi i vitit 2017, me ndihmë të SHGM-së, u formua Shoqata e e mediave të shkruara e cila lobon tek Qeveria për subvencionim të gazetave. Modeli²⁸ të cilin SHMSH e propozoi përbëhet nga ndihmë për mbulimin e gjysmës së harxhimeve për shtypje dhe shpërndarje të të gjithë mediave të shkruara, si dhe 20 për qind plotësuese për të ndihmuar mediat e bashkësive më të vogla etnike, me çka do të plotësoheshin kriteret nga Konventa e UNESCO-s dhe BE-së, për ndihmë të mediave të bashkësive më të vogla etnike, me qëllim që të mbrohet dhe promovohet identiteti i tyre kulturor dhe gjuhësor.

Qeveria parimisht ka shprehur interes për të mbështetur gazetatat, dhe për këtë shkak, kjo është parashikuar në planin 18 i cili është dokument për politika strategjike reformuese të Qeverisë.

25 Marina Tuneva, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik i vitit 2017.

26 SHGM, "Përhëndesim shfuqizimin e reklamimit qeveritar", Shkup, 2018 <http://znm.org.mk/?p=3671>, qasur më 25 korrik, viti 2018.

27 Mediaobservatorium, "Janë përgatitur ndryshimet në ligjin kyç për media", Shkup, viti 2018, <http://mediaobservatorium.mk/podgotveni-se-izmenite-na-kluchniot-mediumski-zakon/> qasur më 8 gusht të vitit 2018.

28 Evropa e Lirë, "Nevojiten subvencione, e jo korruptim i ri i gazetave", Shkup, 2018 <https://www.slobodnaevropa.mk/a/28943545.html> qasur më 25 korrik të vitit 2018.

Përkundër faktit që Qeveria solli vendim që të mos harxhohen para publike në media private, dhe kjo gjë kryesisht respektohet nga institucionet e pushtetit qendror, kjo praktikë është ndryshe në nivel lokal. Për nevojat e këtij raporti, SHGM dorëzoi deri tek të gjithë komunat kërkesë për informacion lidhur me harxhimet e tyre në mediat private, por edhe për marrëveshjet direkte në vepër, gjatë gjysmës së vitit 2018, dhe për harxhimet që planifikojnë ti bëjnë deri në fund të vitit.

Dy e treta e komunave kanë dhënë përgjigje, ndërsa pjesa tjetër e komunave nuk na janë përgjigjur. Sipas të dhënave që i kemi marrë, në pjesën e parë të vitit, komunat kanë harxhuar mbi 15 milion denarë për reklama. Por deri në fund të vitit planifikohet të harxhohen edhe 15 milion denarë të tjera. Sipas këtyre të dhënave, rreth 500 mijë euro, para publike, do të harxhohen në mediat lokale dhe rajonale për reklamime të ndryshme. Kjo shumë sigurisht se është shumë më e madhe, duke marrë parasysh faktin se 18 komuna nuk na kanë dorëzuar përgjigje për harxhimet e tyre.

Cilat janë mekanizmat për financim të mediave që raportojnë në gjuhët e komuniteteve?

Në kuadër të servisit radiodifuziv, ekzistojnë servise në gjuhët e komuniteteve në RM - në programin radio dhe televiziv.

Mekanizma të tjera për financim të mediave në gjuhë të komuniteteve nuk ekzistojnë.

A është e garantuar pavarësia dhe autonomia e RTVM-së? A siguron ky model i financimit financim të pavarur dhe stabil?

Servisi publik nuk ka pavarësi dhe qëndrueshmëri financiare. Qëndrimi i SHGM-së është se Qeveria dhe opozita punojnë së bashku, pas shpine, kundër zbatimit të rekomandimeve të Komisionit Evropian për reforma në servisin publik. Qeveria e sulmon pavarësinë financiare të RTVM-së, nëpërmjet përgjysmimit të burimeve të financimit, ndërsa opozita nëpërmjet obstrukcioneve ndaj ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për Media, tenton që ti mbajë ushtarët partiak që janë të pozicionuar në bordet udhëheqëse të servisit publik.

SHGM vlerëson se Qeveria po e cenon autonominë institucionale dhe pavarësinë e RTVM-së, me atë që zyrtarë të lartë qeveritar, publikisht iu bëjnë thirrje personave udhëheqës që të japin dorëheqje, në vend se të gjejë zgjidhje sistematike për politizimin dhe partizimin e organeve drejtuese të këtij institucioni. Ajo ndërhyr në sistemin e financimit të RTVM-së, në kundërshtim me ligjin i cili parashikon 0.5 për qind nga buxheti që të shfrytëzohet për financim të servisit publik, dhe nga ana tjetër, servisi ende trajtohet si ndër-marrje publike²⁹.

Për financimin e servisit publik, SHGM propozoi një zgjidhje konsenzuale për rritje progresive të buxhetit të servisit publik, duke filluar me 0.8 për qind në vitin 2018, dhe duke mbaruar me 1 për qind nga buxheti i vitit 2020.

29 SHGM, "Reforma në RTVM me më shumë para dhe me më pak ndikim partiak", Shkup, 2018 <http://znm.org.mk/?p=4469> qasur më 7 gusht të vitit 2018.

A.2. A kanë efekt frikësimi tek gazetarët, ligjet për shpifje?

Shpifja dhe ofendimi u dekriminalizuan në vitin 2012 me sjelljen e Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje³⁰. Gjatë vitit të kaluar nuk janë bërë ndryshime në këtë ligj, edhe pse siç ishte konstatuar më lartë, Qeveria në planin 18 ka parashikuar intervenime ligjore të cilat sipas paralajmërimeve, duhet të korrespondojnë me trendët e reja evropiane të këtyre veprave.

Në periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2015, në gjykatë është ngritur një numër i madh kontestesh ku si paditës, paraqiteshin funksionarë të lartë shtetëror, ndërsa si të pandehur, gazetarë që ishin kritik ndaj pushtetit. Në vitin 2016 dhe 2017, sipas të dhënave të SHGM-së, u shënuar një trend i uljes së numrit të këtyre rasteve, respektivisht, u shënuan afro 30 raste në nivel vjetor. Nuk ekziston ndonjë evidencë e saktë se sa është përqindja e këtyre rasteve të iniciuara nga administratorë shtetëror ose politikanë, por përshtypja e përgjithshme nga intervistat e realizuara dhe ndjekja e vazhdueshme e praktikës gjyqësore, është se ofendimi dhe shpifja, tashmë shumë më pak përdoren nga pushteti për presion ndaj gazetarisë kritike.

Përrashtim bëjnë paditë për ofendim dhe shpifje të përfaqësuesve të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) që janë ngritur kundër mediave kritike në gjuhën shqipe. BDI është partner koalicioni i LSDM-së në Qeveri, dhe ishte pjesë e koalicionit të mëparshëm qeveritar me VMRO-në gjatë dhjetë viteve të fundit. Si ilustrim për këtë trend mund ta marrim verdiktin për dëmshpërblim prej 20 mijë eurosh për gazetarin dhe kryeredaktorin e gazetës "Lajm", Isen Saliu. Padia është dorëzuar nga vetë lideri i BDI-së Ali Ahmeti. Verdikti është sjellë lidhur me një shkrim të publikuar në shkurt të vitit 2016.

A shkakton ky verdikt ose kjo sjellje e BDI-së efekt të vetë-censurimit tek gazetarët?

Gjykatat e Maqedonisë nuk e zbatojnë tërësisht Ligjin për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje. Ata kanë një praktikë të ndryshme ndaj deklaratave shpifëse që janë publikuar në mediat online.

Gjykata Themelore e Shkupit por edhe Gjykata e Apelit, i refuzojnë paditë për shpifje kundër mediave online, pasi që në Ligjin për Media, ato nuk trajtohen si media, edhe pse në Ligjin për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, ekziston një nen i veçantë i cili e rregullon mënyrën e veprimit të gjykatës kur të ketë deklarata shpifëse në media online. Për dallim prej gjykatave të Shkupit, gjykatat e apelit në Manastir dhe Ohër, i procedurojnë paditë për ofendim dhe shpifje kundër mediave

online, dhe vendosin në mënyrë meritore.

SHGM e vlerëson këtë praktikë si të papranueshme pasi që paraqet tentativë për licencim.

"Kjo praktikë ka një prapavijë politike me të cilën tentohet që të diskreditohej mediat online, dhe kështu Qeverisë do ti sigurohej një alibi e rrejshme për të vendosur rregullativë më rigorozë ndaj tyre, gjë që është në kundërshtim me standardet evropiane për liri në internet".

SHGM dorëzoi iniciativë me shkrim deri tek Gjykata Supreme, me kërkesë që në afat sa më të shkurtër, të harmonizojë praktikën gjyqësore dhe në të ardhmen, Gjykata Civile dhe Gjykata e Apelit në Shkup, ti procedurojnë lëndët.

Në raportin e fundit mbi Zbatimin e Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje në procedurat gjyqësore kundër gazetarëve, ku analizohen më shumë procedura civile, janë sjellë përfundimet që vijojnë:

„1. Numri i lëndëve gjyqësore kundër gazetarëve, është ulur në mënyrë të konsiderueshme, dhe është shumë më i vogël në katër vitet e fundit, dhe nuk paraqiten verdikte me gjoba të larta në para ndaj gazetarëve, me përjashtim të rasteve individuale (Shembull: Mijalkov kundër Fokusit). 2. Veprimet në të cilat si palë kanë marrë pjesë bartës të funksioneve publike, janë zhvilluar shumë më shpejtë, ndërsa gjatë veprimit të gjykatësve është vërejtur një tendencë e mbrojtjes pa bazë, të nderit dhe imazhit të funksionarëve. 3. Harxhimet për zhvillimin të procedurave para gjykatave civile janë tejet të larta, dhe kjo ju mundëson atyre që padisin gazetarë, të bëjnë kërkesa të larta për dëmshpërblim nga gjykata, dhe 4. Përkundër përpjekjeve të Akademisë për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publik, SHGM-së dhe organizatave të tjera, ende një numër i madh i gjykatësve nuk është mjaftueshëm i trajnuar për procedura gjyqësore që kanë të bëjnë me ofendim dhe shpifje dhe për shfrytëzim të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut”³¹.

31 SHGM, "Zbatimi i Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje në procedurat gjyqësore kundër gazetarëve", Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%9F%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%B3%D1%80%D0%B0%D1%93%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%B0-%D0%BE%D0%B4%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%BA%D0%BB%D0%B5%D0%B2%D0%B5%D1%82%D0%B0-%D0%B8-%D0%BD%D0%B0%D0%B2%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B0-%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%83%D0%B4%D1%81%D0%BA%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BF%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BF%D0%BA%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%B8%D0%B2-%D0%BF%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%80%D0%B8.pdf> qasur më 22 gusht të vitit 2018.

A.3. A ekziston mbrojtje e mjaftueshme juridike për pluralizmin politik në media, para dhe pas fushatave zgjedhore?

Gjatë periudhës që përfshin këtë raport, janë organizuar zgjedhje lokale, më 15 dhe 29 tetor të vitit 2017. Gjatë këtij cikli zgjedhor, Agjencia e Mediave ka ndjekur respektimin e obligimeve ligjore dhe shkeljet potenciale dhe ankesat, i përcillte deri tek gjykata kompetente.

Agjencia e mediave përcolli raportimin e mediave lidhur me fushatën zgjedhore, në mënyrë permanente, dhe publikonte vazhdimisht raporte në ueb faqen e saj.

Agjencia ka ngritur 14 procedura kundërvajtëse kundër 9 shtëpive mediatike, për shkelje të lidhura me reklamimin politik, raportimin e pabalancuar, publikimin e anketave dhe shkelje të tjera të heshtjes zgjedhore.

Gjykatat Themelore kanë sjellë katër vendime në 4 raste. Në tre raste kanë sjellë vendim ose kanë imponuar gjobë më të ulët se sa ajo që është parashikuar në Kodin Zgjedhor, dhe në një rast ka dhënë vetëm paralajmërim zyrtar. Për dy vendime Agjencia e Mediave është ankuar, pasi nuk ka qenë e kënaqur nga lartësia e gjobave. Sipas raportit të OSBE/ODIHR. “Agjencia e Mediave e dëshmoi profesionalitetin e saj gjatë zgjedhjeve, duke vënë në funksion të plotë mandatin e saj, por efikasiteti i verdikteve ndaj ankesave lidhur me mediat, ishte mbuluar me faktin që gjykatat i tejkaluan afatet ligjore, dhe sollën verdikte me gjoba më të ulëta se sa ato që parashikohen me ligj”³².

Lidhur me raportimin e RTVM-së, vlerësimi i misionit ndërkombëtar që monitoroi zgjedhjet është se RTVM ka siguruar përfaqësimin e të gjithë kandidatëve, falas dhe në terminet kryesore. Por megjithatë, këtë mundësi nuk e kanë shfrytëzuar të gjithë kandidatët. Një prej konkluzave në raport është se “RTVM-së i mungoi raportim më i thellë, gjë që i kufizoi informatat analitike që duhej tu përcillen votuesve, dhe kishte një mbulim të thatë për kandidatet dhe politikanet femra”.

OSBE/ODIHR e komentoi edhe kërkesën ligjore që RTVM të kushtojë një kohë të caktuar për të mbuluar fushatën e partive politike. Sipas tyre, kjo zgjidhje duhet zëvendësuar me diçka më të përgjithshme si për shembull “qasje e drejtë dhe mbulim informativ i partive më të vogla dhe kandidatëve të pavarur, si dhe ruajtje e balancit mes principit të mundësive të barabarta mes pjesëmarrësve, pluralizmit të pikëpamjeve dhe lirisë mediatike”.

Në krahasim me ciklet e mëparshme zgjedhore kur ishte konstatuar mungesë e mbulimit të drejtë të fushatave të partive të atëhershme opozitare, qëndrimi i Misionit të OSBE-së është se këtë herë kishte më shumë përfaqësim të drejtë të partive politike në mediat private elektronike. Sipas monitorimit të OSBE-së, në rrethin e parë, LSDM ka fituar 40%, VMRO DPMNE 35%, ndërsa BDI 9%. Tek gazetatat, konstatim i OSBE-së është se në të dy rrethet zgjedhore, gazetatat që ishin nën monitorim, kanë siguruar më së shumti hapësirë për dy partitë më të mëdha, LSDM dhe VMRO, ndërsa kanë patur tone neutrale, përveç gazetës “Sloboden Peçat”. Të gjithë e kanë respektuar periudhën e heshtjes zgjedhore, në të dy rrethet zgjedhore, përveç gazetës “Sloboden Peçat”.³³

Me ndryshimet e mëparshme të Kodit Zgjedhor në vitin 2016, ishte paraparë që Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të monitorojë edhe mediat online. Por, edhe përkundër obligimit ligjor, Agjencia nuk e mbikëqyri raportimin e mediave online, pasi një praktikë e tillë rregullatore në Evropë nuk ekziston.

Më 25 korrik të vitit 2018, në mënyrë tejte jo transparente, pa debat adekuat publik, Qeveria dhe opozita arritën marrëveshje politike për ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Zgjedhor. Me këto ndryshime, reklamimi i paguar politik i partive gjatë procesit zgjedhor, do të paguhet me para publike.

Gjithashtu, ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Zgjedhor, i japin autorizim Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve që ti regjistrojë mediat online që do të raportojnë mbi zgjedhjet, si dhe ta monitorojë mënyrën e raportimit. Në rast të raportimit të pabalancuar, KSHZ munde të shqiptojë gjoba në lartësi prej 4 mijë eurosh.

Gjobat do të caktojë një trup që do të funksionojë në kuadër të KSHZ-së. Përveç kësaj, me nenin 3, paragrafi 11, pjesëmarrësve në zgjedhje, u jepet edhe obligimi që të dorëzojnë plane mediatike për reklamim politik, që do të paguhet nga Buxheti i RM-së tek mediat private.

Paraprakisht, qëndrimi i SHGM-së dhe organizatave të tjera mediatike, që ishte i njohur edhe për partitë, ishte që gjatë fushatës zgjedhore, të ndërpritet reklamimi politik në media private, me para shtetërore. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor jo vetëm që e legjitimojnë këtë gjë, por edhe ndihmojnë në ruajtjen e lidhjeve klienteliste mes partive politike dhe pronarëve të mediave që janë krijuar me reklamimin qeveritar dhe

32 Raporti final i Misionit për monitorimin e zgjedhjeve, OSBE/ODIHR, faqe 20.

33 Raporti final i Misionit për monitorimin e zgjedhjeve, OSBE/ODIHR, faqe 23.

sistemin e subvencionimit të programit vendor në televizionet kombëtare. Për këtë shkak, SHGM së bashku me Sindikatën e Gazetarëve, dhe Këshillin e Etikës në Media, reagueshan për në këto ndryshime dhe plotësime të Kodit Zgjedhor, duke vlerësuar se të njëjtat e cenojnë lirinë e mediave, pasi u mundësojnë partive që ta kontrollojnë politikën e tyre redaktuese³⁴. Qëndrimi i më shumë organizatave dhe ekspertëve mediatiq është se këto ndryshime në Kodin Zgjedhor, nuk shkojnë në favor të reformave të planifikuara mediatiqe, dhe do të ndikojnë negativisht mbi punën e mediave dhe ambientin e tërë demokratik gjatë fushatës parazgjedhore.

Në vijë të ngjashme ishte edhe reagimi i Agjencisë së mediave e cila këto ndryshime i vlerësoi si skandalozë³⁵. Sipas Agjencisë së Mediave, në praktikën evropiane ekzistojnë disa raste të izoluara për kompensim të harxhimeve të mediave, nga buxheti i shtetit, gjatë periudhës së zgjedhjeve, por për mediat të cilave u imponohet obligimi për reklamim politik pa pagesë të pjesëmarrësve në zgjedhje, në kushte kur është ndaluar reklamimi politik me pagesë, gjë që nuk është rast në Maqedoni.

Edhe SHGM edhe ASHAHV, i vlerësuan dispozitat ligjore si zgjidhje katastrofale që ndërhyjnë në lirinë redaktuese të mediave, pasi pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore do ti përgatisin planet mediatiqe për reklamim të paguar politik, në vend se ti përgatisin vetë mediat. Me mbështetje të qëndrimit të SHGM-së, doli edhe Federata Evropiane e Gazetarëve³⁶ ndërsa në platformën e Këshillit të Evropës³⁷, për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, ishte publikuar një alarm për shkak të këtyre ndryshimeve, që mund ta kufizojnë lirinë e mediave.

A.4. A ka garanci ligjore për veprimtarinë e gazetarisë dhe zbatohet ky ligji?

Në Maqedoni, profesioni i gazetarit nuk është i licencuar, por në ligjin për media, ka një definicion për atë se çfarë paraqet një gazetar.

“Person i cili mbledh, analizon, përpunon ose klasifikon informacione të publikuara në media, dhe është i/e punësuar në media, ose ka një kontratë pune me to, ose është person i cili bën aktivitete gazetareske si një profesion i pavarur (gazetar i lirë)”.

Në Maqedoni, profesioni i gazetarisë nuk është i licencuar, kryesisht për shkak të insistimit të shoqërisë gazetareske e cila reagoi gjatë sjelljes së Ligjit për Media. SHGM-ja dhe organizatat e tjera ishin dhe ende janë kundër definimit të profesionit të gazetarisë me ligj, pasi kështu krijohet mundësi për kufizim të lirisë së gazetarëve. Gazetaria profesionale mund të jetë lëndë e vetërregullimit, por jo edhe rregullimit ligjor. Për këtë shkak, zotimi i SHGM-së është që ky nen i ligjit, të largohet tërësisht.

Për herë të parë, pas një periudhe më të gjatë të përkeqësimit në raportet e organizatave ndërkombëtare që merren me vlerësimin e lirisë së mediave, Maqedonia shënon një përmirësim të vogël. Kështu, në raportin e Freedom House, gjendja është vlerësuar me notën 5, që është përmirësim nga nota e vitit të kaluar që ishte 5.25. Ngjashëm, në radhitjen e vitit të kaluar në raportin e “Reporterëve pa kufij”, Maqedonia shënon një rritje të vogël nga vendi i 111-të, në vendin e 109-të³⁸.

Këto vlerësime kryesisht i kanë dhënë edhe ekspertët mediatiq, të intervistuar për nevojat e këtij raporti:

“Po, gjendja e lirisë së mediave është përmirësuar, por fjala “drastike” është ende e papërshtatshme. Unë do thoja se gjendja është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme”³⁹.

34 SHGM, “Ndryshimet në Kodin Zgjedhor, e kërcënojnë punën dhe lirinë e mediave”, Shkup, viti 2018, <https://znm.org.mk/?p=4571> qasur më 16 gusht, viti 2018.

35 Pravdiko, “ASHAAV: Zgjidhje skandalozë në ndryshimet e Kodit Zgjedhor”, Shkup, viti 2018, <https://www.pravdiko.mk/avmu-skandalozni-reshenija-vo-izmenite-na-izborniot-zakonik/#more-65905> qasur më 22 gusht të vitit 2018.

36 SHGM, “Mbështetje nga FEG për SHGM lidhur me ndryshimet në Kodin Zgjedhor”, Shkup, 2018, <https://znm.org.mk/?p=4607> qasur më 16 gusht të vitit 2018.

37 SHGM, “Këshilli i Evropës alarmon për ndryshimet restrictive në Kodin Zgjedhor për mediat”, Shkup, 2018, <https://znm.org.mk/?p=4597> qasur më 22 gusht të vitit 2018.

38 Reporterë pa kufij, Rangimi I MAqedonisë për vitin 2018, <https://rsf.org/en/republic-macedonia>.

39 Tamara Çausidis, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik, 2017.

“Nuk do të thoja se është përmirësuar në mënyrë drastike. Do thoja se ndodhi një lëvizje e gjërave, nga pika e fundit në lirinë e mediave, deri në pikën kur filloi ngadalë të krijohet shpresa se do të hyjmë në një periudhë të reformave të vërteta që do ti bëjnë mirë edhe gazetarisë por edhe mediave në përgjithësi”⁴⁰.

Në Maqedoni, gjatë viteve të fundit, në disa raste kishte iniciativa që vinin nga qarqe të afërta me pushtetin për vendosjen e licencave për profesionin e gazetarisë dhe për rregullimin e sferës online, me argument kryesor, se ka shumë gazetarë joetike dhe joprofesionale. Mbizotëronte një kuptim se profesioni i gazetarisë dhe puna e gazetarëve, duhet të definohet ose të përfshihet në ndonjë ligj të përgjithshëm për media ose ngjashëm, me qëllim që të vendoset një rregull, sidomos një sferën online. Ndaj kësaj tendence kontribuuan edhe vendimet e disa gjykatave që të mos i pranojnë paditë për ofendim dhe shpifje të dhëna në mediat online, pasi sipas tyre, këto media nuk janë të përfshira në asnjë ligj mediatik. ME këtë, krijohet një klimë në opinion e cila mund të sjellë përsëri idenë ose mbështetjen për licencimin e mediave online.

Përveç kësaj, me vendimet e tilla, gjykatat de fakto diktojnë, jashtë kompetencave të tyre, se kush mund e kush jo të jetë gazetar, gjë që është në kundërshtim me praktikën e vendeve të zhvilluara. Kundër rregullimit të mediave online, deklarohen edhe një pjesë e bashkëbiseduesve të intervistuar:

“Rregullimi i mediave online është i palejueshëm dhe praktikë e panjohur në shoqëritë demokratike. Mund të bisedohet ndoshta për njoftimin/regjistrimin e mediave online, sikurse që është rasti tek mediat e shkruara. Këtë gjë e sygjeron edhe studimi i Këshillit të Evropës”⁴¹.

Është fakt se një pjesë e mediave dhe gazetarëve, duke kritikuar shkeljet e standardeve gazetareske dhe të drejtave autoriale nga ana e vetë mediave, bëhen në fakt mbështetës të rregullimit ligjor të profesionit. Sipas Marina Tunevas: “Ajo që shqetëson është që prej mosdijes, një pjesë e shoqërisë mediatike, po ashtu e përkrah këtë tendencë. Duke mos mundur të ballafaqohen me mosrespektimin e të drejtave të autorit dhe mungesën e një tregu vetërregullues, anojnë kah favorizimi i rregullimit ligjor”⁴².

Një konkluzë e përgjithshme nga intervista me 13 gazetarë, të realizuara për nevojat e këtij raporti, lidhur me lirinë e profesionit të gazetarisë në redaksi dhe jashtë saj, është se gjatë periudhës së kaluar, ajo shënon një përmirësim të vogël.

Shumica e gazetarëve janë pjesë e organizatave profesionale. Shoqata më e vjetër dhe më e madhe është SHGM, që është themeluar në vitin 1946m është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve dhe Federatës Evropiane të Gazetarëve. Është një shoqatë e pavarur, joqeveritare dhe jopolitike që ka për qëllim të mbrojë dhe promovojë lirinë e shprehjes dhe gazetarinë etike⁴³.

Nga viti 2010, pas ndryshimeve në Statut, kryesia e SHGM-së zgjidhet nëpërmjet zgjedhjeve të lira, në të cilat marrin pjesë të gjithë anëtarët e organizatës, sipas principit një anëtar – një votë. Zgjedhjet e ardhshme për kryesinë e re të SHGM-së do të organizohen në dhjetor të vitit 2018, kur pritet të zgjidhet kryesia e re e Shoqatës. Për momentin, numri i anëtarëve të rregullt në SHGM është 680 anëtarë.

40 Marina Tuneva, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik, 2017.

41 Zoran Trajčevski, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik, 2017.

42 Marina Tuneva, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik, 2017.

43 Informata lidhur me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë, mund të gjenen në ueb faqen e saj: http://znm.org.mk/?page_id=719&lang=en.

Asociacioni Maqedonas i Gazetarëve (AMG) ekziston prej vitit 2003, ndërsa ishte riaktivizuar në vitin 2013. Të gjithë qëndrimet e saj lidhur me situatën në sferën mediatike, janë të ngjashme me ish partinë në pushtet, VMRO DPMNE. Në korrik të këtij viti, është mbajtur një Kuvend zgjedhor i ri, ndërsa në zgjedhjen e kryesisë së re morën pjesë rreth 20 gazetarë. AMG nuk ka një ueb faqe dhe është e paqartë se kënd e ka anëtar, sa anëtarë ka gjithsej dhe cilat janë metodat me të cilat komunikon me anëtarësinë e saj dhe si e informon opinionin. AMG po ashtu nuk ka as një kodeks etik të gazetarëve.

Sindikata e pavarur i gazetarëve dhe punonjësve mediatik (SPGPM)⁴⁴, është organizatë e cila është themeluar në vitin 2010, dhe paraqet organizimin e vetëm sindikalist të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Edhe pse në media dolën informacione për themelimin e një sindikate të re, paralele, “pro qeveritare”, në të cilën do të anëtarësoheshin gazetarë që janë të afërt me ish partinë në pushtet, si pandan i AMG-së, që është një organizatë pro qeveritare, megjithatë, pasi ish partia në pushtet kaloi në opozitë, kjo iniciativë nuk u jetësua asnjëherë.

Këshilli për Etikë në Mediat në Maqedoni (KEMM), ekziston prej vitit 2013, si një trup për vetërregullim në media, dhe aktivitetin e saj kryesisht e bazon në konstatimin e sanksioneve publike morale, për ato media që nuk i respektojnë standardet profesionale dhe etike, Kodeksin e gazetarëve, dhe principet e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve.

A.5. Sa është niveli i mbrojtjes juridike të burimeve të gazetarëve?

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e garanton të drejtën e fshehtësisë së burimit të gazetarit⁴⁵, sipas të cilës, gazetari ka të drejtë që të mos e zbulojë burimin e informacionit ose të mos zbulojë informata me të cilat do të zbulohet identiteti i burimit.

Në Kodin Penal, nuk ka kufizime lidhur me mbrojtjen e burimeve të gazetarëve. Por, me rëndësi është që të theksohet se edhe përkundër mungesës së kufizimeve, në vitin 2013, gjykata ka shfrytëzuar një dispozitë ligjore për moszbulimin e identitetit të dëshmitarit të mbrojtur, për ta mbyllur një gazetar, kjo për shkak se gjatë procedurës hetimore, ai ka refuzuar që ta tregojë burimin e storjes së tij të publikuar në vitin 2008.

Ligji për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje e rregullon përgjegjësinë për dënim e shkaktuar mbi nderin dhe imazhin e personave fizik dhe juridik, me shpifje ose ofendim, por konstaton po ashtu se gazetarët nuk mund të obligohen që ti zbulojnë burimet e tyre. Gjykata mund ti kërkojë gazetarit që të zbulojë informacione që të dëshmojë vërtetësinë e deklaratimeve të publikuara, por pa e identifikuar burimin e informatës.

Gjatë periudhës së raportimit, nuk janë konstatuar raste të reja të cenimit të të drejtës së fshehtësisë së burimit të informacioneve.

44 Informata për SPGPM mund të gjenden në ueb faqen në vazhdim: <http://ssnm.org.mk/?lang=en>.

45 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 16.

A.6. Sa është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje deri tek informatat me karakter publik?

Ligji për qasje deri tek informatat me karakter publik, u votua në vitin 2006, dhe disa herë ishte ndryshuar dhe plotësuar⁴⁶. Siç është konstatuar në raportin e vitit të kaluar, Ligji nuk është i harmonizuar tërësisht me principet themelore të vërtetuara me të drejtën ndërkombëtare.

Afati prej 30 ditësh për të marrë informatë me karakter publik është tejte i gjatë për gazetarët, ndërsa ekzistojnë baza të ndryshme mbi të cilat institucionet shtetërore, mund të refuzojnë qasje deri tek informatat të caktuara. Në praktikë, gjatë vitit 2016 dhe 2017, është konstatuar se Ligji zbatohet pjesërisht ose fare nuk zbatohet. Madje 87% e gazetarëve të anketuar në vitin 2016, që kanë marrë përgjigje në kërkesat e tyre, i kanë vlerësuar përgjigjet e marra si jo të plota.

Në vitin 2017, SHGM së bashku me disa organizata mediatike kanë kërkuar ndryshime në Ligjin për qasje deri tek informatat me karakter publik, me qëllim që të vërtetohet ndonjë afat më i shkurtër për qasje, që do tu mundësonte gazetarëve që të vijnë tek informatat dhe të dhënat e nevojshme, më shpejtë (mundësisht për 7 deri në 10 ditë pune). U kërkuar që të ngushtohet edhe rrethi i bazave për refuzim të kërkesave, në mënyrë që të mos u lihet hapësirë institucioneve për interpretim kokë më vete të bazës për refuzim, e që për qëllim ka fshehjen e informatave⁴⁷.

Këtë vit, ka nisur procesi i ndryshimeve në Ligj. Informatat e fundit lidhur me projektin ligjor, është nga marsi i vitit 2018. Komisioni për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik është jofunksional, pasi tre prej pesë anëtarëve të komisionit, kanë dhënë dorëheqje. Në kuadër të këtij hulumtimi të tretë, SHGM kërkoi qasje deri tek informatat me karakter publik të të gjithë komunave, me kërkesë për informatë mbi harxhimet ose harxhimet e planifikuara për reklamim gjatë vitit 2018. Gjatë afatit ligjor, përgjigje kanë dhënë 62 komuna, ndërsa 18 nuk kanë kthyer përgjigje. Një pjesë e komunave siç janë Kavadarci dhe Strumica, kanë dorëzuar përgjigje që nuk korrespondojnë me përgjigjet e tyre të mëparshme, dorëzuar gazetarëve, e që janë për pjesën e parë të vitit 2018, dhe për planet e harxhimeve për pjesën e dytë të vitit.

Një prej projekteve ligjore që janë vendosur në procedurë, është Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik. Arsyeja për ndryshimet e propozuara është zbatimi jo i plotë dhe joadekuat i Ligjit. Kjo nxit nevojën për përmirësimin e të njëjtit. Kjo ishte theksuar edhe në versionet e mëparshme të këtij raporti, si vështirësi me të cilën ndeshen gazetarët gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale. Por edhe vetë SHGM-ja ndeshet me vështirësi gjatë punës, sidomos gjatë kërkesave për sigurimin e të dhënave nga institucionet, për nevojat e raporteve.

46 Ligji për qasjen deri tek informatat me karakter publik.

47 LSGPM, "Kërkesa për reforma sistematike në media", Shkup, viti 2017. <https://ssnm.org.mk/%D0%B1%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%9A%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D1%81%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BC%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D1%80%D0%B5%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC/> qasur më 25 korrik të vitit 2018.

B

**Indikatorë për nivelin e
lirisë së mediave dhe sigurinë
e gazetarëve në Maqedoni**

Edhe këtë vit, analiza tregon se ende ekzistojnë kufizime serioze të lirive të gazetarëve në Maqedoni, si rezultat i statusit të keq ekonomik dhe social të gazetarëve. Edhe më tej, rrogat e gazetarëve mbeten të ulëta, dhe janë nën mesataren e rrogave mujore në nivel shtetëror, ndërsa përqindja e gazetarëve që kanë një vend të sigurtë pune me marrëveshje të vazhdueshme për punësim dhe me kontribute të paguara e benefite, është tejet e ulët.

Këto të dhëna burojnë nga intervistat me gazetarët dhe përfaqësuesit e organizatave dhe institucioneve mediatike, të realizuara për nevojat e këtij hulumtimi, e që kanë të bëjnë me profesionalitetin, situatën ekonomike dhe sociale të gazetarëve. Përveç kësaj, janë marrë parasysh edhe publikimet dhe raportet e këtij viti nga më shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare, që e analizojnë gjendjen e lirisë së shprehjes dhe të drejtave të gazetarëve në Republikën e Maqedonisë.

Në vitin 2018, vazhdon trendi i mbylljes së mediave, por për momentin ka edhe media që janë në procedurë falimentimi. Me këtë gjendje, ndikohet direkt edhe në numrin e të punësuarve në sektorin mediatik.

Shpesh, gazetarët që mbeten pa punë, hapin portale informative ose kalojnë në portale ekzistuese, që kanë numër më të vogël të punësuarish. Kjo ndikon në cilësinë e përmbajtjeve të publikuara dhe shpesh shkelen edhe standardet profesionale dhe etike. Në kushte kur gazetarët janë të eksponuar në trysni brenda redaksive, shpesh nga frika, por edhe për shkak të mungesës së informacioneve mbi të drejtat e tyre, nuk ngrisin padi. Prandaj, **Në Maqedoni ende nuk ka asnjë rast të mobingut që është ngritur me iniciativë të ndonjë gazetari.**

B.1. A keqpërdoret pozita ekonomike e gazetarëve me qëllim që të kufizohet liria e tyre?

Pavarësia ekonomike e gazetarëve, është një prej parakushteve për gazetari profesionale, prandaj edhe është e nevojshme të vendosen mekanizma mbrojtëse që do tu mundësojnë gazetarëve ta bëjnë punën e tyre pa presione.

Pozita ekonomike e gazetarëve keqpërdoret për ta kufizuar lirinë e tyre. Prej pyetësorëve që u janë dorëzuar anëtarëve të SHGM-së, respektivisht prej përgjigjeve të tyre, kemi ardhur në përfundim se, **rroga mesatare e gazetarëve është 18.800 denarë neto, për një muaj, që është rreth 30% më pak se rroga mesatare në vitin 2018.** Gjysma prej tyre nuk kanë marrëveshje punësimi në afat të pacaktuar, ndërsa një pjesë e vogël janë angazhuar me kontratë autoriale. Këto gjetje i vërtetojnë edhe rezultatet nga analiza e fundit e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik, e realizuar gjatë muajit korrik dhe muajit gusht të vitit 2017, ku kanë qenë të përfshirë 127 punonjës mediatik⁴⁸. Sipas kësaj analize, 85% e gazetarëve kanë rrogë më të vogël se 500 euro në muaj ndërsa 45% e gazetarëve marrin rrogë më të vogël se përqindja mesatare në nivel shtetëror.

Një pjesë e anëtarëve të SHGM-së që u përgjigjën në pyetësorët tonë, theksojnë se punojnë për më pak se 12 mijë denarë në muaj, ndërsa një informatë tjetër që bie në sy është dallimi i madh i rrogave mes gazetarëve nga qytetet e tjera dhe atyre që punojnë në Shkup. Lidhur me pagesën e rregullt të rrogave të gazetarëve, sipas hulumtimit të fundit të Sindikatës⁴⁹, më shumë se 55% të gazetarëve iu vonohen rrogat. Në këtë drejtim, d-r Snezhana Trpevska komenton:

“Së bashku me sigurinë, çështja socio-ekonomike dhe statusi i punës është kyç. Një gazetar ka mundësi që në afat të shkurtër të durojë presione, por nëse për vite me radhë nuk merr rrogë të rregullt dhe të mjaftueshme, nuk e ka punën e sigurtë, nuk ndjehet i mbrojtur gjatë marrëdhënies së punës, dalëngadalë do të bëhet pre e presioneve”.

48 SPGPM, “Rroga në media, e bllokuar nën mesataren”, Shkup, 2017, <https://ssnm.org.mk/платата-во-медиумите-заглавена-под-ип/> qasur më 4 gusht të vitit 2018.

49 Tamara Çausidis, intervistë me anëtar të ekipit të SHGM-së, korrik 2017.

Censura në media është ende e pranishme, ndërsa gazetarët ende kanë frikë që ta denoncojnë. Në këtë drejtim, Trpevska shton:

“Frika buron nga pasiguria e tyre, në kontekst të vendit të punës, rrogës, peshës së vetë profesionit. Gjatë viteve janë shndërruar në konformistë, pra nuk është e lehtë të jesh gazetar, sidomos nëse nuk je i mbrojtur, dhe një kolegj që e kanë humbur punën, ose ju është kërcënuar drejtori ose pronari. Redaktorët, sipas meje, janë hallka kyçe që luan rol në mbrojtjen dhe inkurajimin e gazetarëve. Në qoftë se ata janë të pavarur dhe profesional, do të ndikojnë në atmosferën e përgjithshme në redaksi”.

Arsyeja për mosparaqitjen e censurës në redaksi, është e lidhur ngushtë problemet socio-ekonomike që i kanë gazetarët. Në këtë drejtim, Tamara Çausidis, kryetare e Sindikatës së Pavarur thotë:

“Frika është e arsyeshme, pasi jo vetëm që do të dënohen me dëbim nga puna (në mundësinë e parë) por nuk do të kenë mbështetje as nga kolegët. Por u zvogëlohen edhe shanset për punësim tjetër pasi do të marrin etiketën “problematik”.

Indikator shtesë se ekziston frikë në mesin e gazetarëve për të folur publikisht për presionet nga redaktorët ose menaxhmenti i mediave, është fakti se shumica e gazetarëve që janë përgjigjur në këto pyetësor, kanë dashur të mbeten anonim.

Një zhvillim pozitiv në vitin 2018, është paralajmërimi për negociata⁵⁰ për të nënshkruar marrëveshje kolektive mes Agjencisë Informativë të Maqedonisë (AIM) dhe Sindikatës të Pavarur, një proces që është mbështetur edhe nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Në rast se në AIM, në ndonjë të ardhme të afërt, nënshkruan marrëveshje kolektive me Sindikatin, kjo do të jetë një shembull pozitiv. Para së gjithash, do të jetë shembull për agjencitë e tjera mediatike, por edhe për mediat komerciale, si dhe do të kontribuojë për një mbrojtje më të madhe sociale të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Pavarësisht gjendjes së vështirë ekonomike në të cilën gjendjen mediat dhe gazetarët në Maqedoni, duhet theksuar se gjatë vitit të fundit, është vërejtur përmirësim i mënyrës së raportimit të mediave dhe prani e dozës më të madhe të kritikës ndaj pushtetit dhe politikës së tij. Një prej arsyeve për këtë gjendje është demokratizimi i sferës publike që ndodhi pas ndryshimit të pushtetit, pasi u pakësua presioni politik ndaj mediave.

Numri i gazetarëve dhe punonjësve mediatik këtë vit, mbetet i panjohur, por supozohet se ka më pak gazetarë se vitet e kaluara. Të dhëna zyrtare ka vetëm për sektorin audiovizual, që i ka publikuar rregullatori mediatik. Kështu, **në vitin 2017, numri total i të punësuarve në mediat radiodifuzive ka qenë 2258, ndërsa në vitin 2016, ky numër ka qenë 2416, që do të thotë se tek të gjithë radiodifuzerët, përfshirë këtu edhe RTMV-në, gjatë vitit 2017, kanë punuar 158 persona më pak se vitin e kaluar.** Prej këtyre personave, shumica kanë qenë të punësuar në servis publik (gjithsej 847 persona). Në sektorin privat, më së shumti ka të punësuar në pesë televizionet kombëtare, ndërsa më së paku në radiot komerciale në nivel shtetëror.

50 SPGPM, “Është dakorduar fillimi i negociatave për marrëveshje kolektive në MIA”, Shkup, 2018, <https://ssnm.org.mk/договорен-почеток-на-преговори-за-кол/>, qasur më 11 gusht të vitit 2018.

B.2. Sa është niveli i pavarësisë redaktuese nga pronarët e mediave dhe organet udhëheqëse?

Mediat private, nuk kanë publikuar në ueb faqet e tyre akte të brendshme organizative, që garantojnë pavarësinë e kolegjiut të redaktorëve nga menaxhmenti i televizionit. Ata madje nuk i respektojnë as obligimet nga Ligji i Mediave⁵¹, i cili në nenin 10, obligon botuesin e mediumit që të sjellë një akt të përgjithshëm me të cilin do të rregullojë: përbërjen e redaktorëve, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e kryeredaktorit, redaktorëve dhe gazetarëve, të drejtat e ndërsjella dhe obligimet mes botuesit të mediumit, kryeredaktorit, redaktorëve dhe gazetarëve, emrin dhe adresën e mediumit, emrin e personit përgjegjës të botuesit, të redaktorëve, në pajtueshmëri me organizimin e brendshëm.

Gazetarët nuk i padisin redaktorët dhe pronarët e mediave kur iu shkelen të drejtat e tyre. Kështu, për momentin nuk është e qartë nëse ekziston ndonjë rast që vijon për mobing ndaj ndonjë gazetari, dhe nuk ka ndonjë verdikt të plotfuqishëm për ndonjë vepër të tillë. Edhe pse në opinion ka patur paralajmërime për padi për mobing në Sindikatën e gazetarëve, megjithatë, sipas kryetares Tamara Çausidis, gjatë vitit të kaluar nuk janë regjistruar raste të tilla. Por kjo nuk do të thotë se gazetarëve nuk u shkelen të drejtat, por arsyet më të shpeshta janë mungesa e njohjes së të drejtave të përgjithshme të punëtorit, e sidomos të të drejtave për mbrojtje nga mobingu, mungesa e besimit në gjykata, dhe marrëveshjet e pavolitshme për punë që në të shumtën e rasteve, janë të kontraktuara në afat të caktuar.

Nga ana tjetër, lidhja mes pronarëve të mediave të caktuara dhe qendrave të fuqisë, është në dëm të gazetarëve që punojnë në këto media. Edhe pse rregullatori mediatik gjatë viteve të kaluara nuk ka zbuluar ndonjë lidhje të tillë, ose ndonjë koncentrim mediatik, megjithatë në opinion kishte një sërë spekulimesh se një pjesë e mediave kombëtare, vetëm formalisht kanë pro-

nar pas të cilëve qëndrojnë qendra të ndryshme të fuqisë që lidhen me elitën e biznesit dhe partitë politike. Një pjesë e mediave të tilla, gjatë periudhës së qeverisjes së VMRO DPMNE-së, financoheshin në masë të madhe nga Buxheti i destinuar për fushatë publik, me çka në mënyrë artificiale mbaheshin në treg. Pas ndërprerjes së reklamimit shtetëror, pozicioni i tyre financiar u përkeqësuar në mënyrë drastike, gjë që ndikoi edhe në pozitën e gazetarëve të punësuar në ato media. Kështu, për shembull, TV Alfa ka një ulje të dukshme të të ardhurave pas ndërprerjes së reklamave qeveritare, për të cilat u vendos moratorium gjatë qershorit të vitit 2015. Shembulli i dytë është radioja kombëtare “Sllobodna Makedonija” e cila në vitin 2018, e humbi licencën për punë, ndërsa është e njohur se edhe shtatë prej gjithsej 9 mediave rajonale, që ishin hapur në vitin 2014, dhe kishin të ardhura tejet të mëdha, tashmë janë mbyllur. Më tej, televizioni kabllovik TV Nova, e cila për momentin është në procedurë falimentimi, kishte të ardhura tejet të mëdha nga fondet publike, por mbeti e paqartësuar edhe informata se ky televizion ka përdorur një pjesë të pajisjeve të RTVM-së.

Shembujt e tillë sipas Zoran Fidanovskit, anëtar në Këshillin e Agjencisë së Mediave, janë tregues për atë se mediat përdoreshin për arritje të qëllimeve politike, ndërsa gazetarët që punonin në këto media, çdo ditë ishin të eksponuar në presione: *“Unë isha dëshmitar kur në një medium, një prej gazetarëve e lexonte tekstin e kronikës nga celulari i tij, pasi shkurtimisht para lajmeve, ia kishin dërguar në formë të sms porosisë”*

Kodeksi i vetëm që vlen për të gjithë gazetarët profesionistë, është Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë, i miratuar në vitin 2001, në bazë të të cilit veprojnë edhe Këshilli i Nderit të SHGM-së, edhe Këshilli i Etikës në media të Maqedonisë.

Shumica e mediave private me ndikim, janë anëtare të Këshillit të etikës, një trup për vetërregullim, i themeluar në vitin 2014. Ata formalisht janë të obliguar që ti përmbahen Kodit të gazetarëve. Përveç Kodit, mbi 90 media private janë obliguar për ta respektuar edhe Konventën për raportin etik gjatë procesit zgjedhor⁵². Megjithatë, një pjesë e madhe e mediave me ndikim të madh mbi opinionin publik, shpesh i shkëllnin këto principe.

51 ASHA AV, “Ligji i Mediave”, Shkup, viti 2017, http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon_z_a_mediumi_mkd.pdf, qasur më 25 korrik të vitit 2018.

52 SPGPM, “Karta për raportim etik gjatë zgjedhjeve”, Shkup, 2017, <http://semm.mk/novosti-4/2015-08-11-15-03-18/499-povelba-za-etichko-izvestuvanje-za-izborite> qasur më 27 nëntor të vitit 2017.

B.3. Cili është niveli i pavarësisë redaktoriale të gazetarëve në servis publik?

Financimi i qëndrueshëm dhe i pavarur i serviseve publike, është një prej parakushteve të parapara në rekomandimet e Këshillit të Evropës, që kanë të bëjnë me themelimin dhe veprimtarinë e serviseve publike. Në kushte kur RTVM-ja është një prej borxhlinjve më të mëdhenj në Republikën e Maqedonisë, dhe gjithnjë e më shumë, ose çdo vit ka buxhet më të ulët, ndërsa obligimet sipas ligjit vetëm u shtohen, nuk mund të presim që ky medium të jetë i pavarur dhe gazetarët të kenë liri në përzgjedhjen e temave dhe mënyrën e raportimit.

Në vitin 2017, përkundër paralajmërimeve disa vjetore, RTVM-ja miratoi Kodin Etik për gazetarët, si një obligim statutar për kuadrot kreative dhe të gjithë të punësuarit në RTMV⁵³. Ky Kodeks ishte pre e shumë kritikave të shoqërisë së gazetarëve, për shkak të përmbajtjes së dokumentit, por edhe për shkak të mungesës të transparencës në procesin e përpunimit të të njëjtit. Mangësia më e madhe e Kodeksit është përzierja e etikës gazetareske, me disiplinën në punë, dhe të drejtat e obligimet e gazetarëve që burojnë nga marrëdhëniet e punës⁵⁴. Presioni që ushtrohet ndaj gazetarëve në RTVM mbetet i njëjtë, duke marrë parasysh se nuk ka ndryshime në menaxhmentin e këtij mediumi, dhe presioni është ndryshe nga ai që e përjetojnë gazetarët që punojnë në mediat komerciale. Në RTVM, gazetarët para së gjithash, ndjejnë presion të brendshëm i cili zbatohet me masa disiplinore nga ana e eprorëve, dënime financiare, shpërndarje në vende të tjera të punës dhe ngjashëm. Në këtë drejtim, gazetar nga televizioni MTV1 i cili dëshoi të mbetet anonim, për nevojat e këtij raporti thotë:

“Presioni subtil për kronika të porositura vazhdon. Zgjidhen gazetarë që janë të dëgjueshëm, dhe që pastaj shpërblehen në mënyra të ndryshme nga menaxhmenti, siç janë variabla, udhëtime zyrtare jashtë vendit dhe ngjashëm”.

Kategori më e rrezikuar janë korrespondentët të cilët janë vetëm disa në numër, dhe më së shpeshti kanë marrëveshje të përkohshme angazhimi, që mund të prishen shumë lehtë, që në fakt ka qenë edhe rast gjatë viteve të kaluara.

53 RTVM-si për gazetarët, kuadrot kreative dhe të gjithë të punësuarit në RTVM”, Shkup, 2017. http://www.mrt.com.mk/sites/default/files/%D0%95%D1%82%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B8%20%D0%BA%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BA%D1%81%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%9C%D0%A0%D0%A2_0.pdf, pristapeno na 29 noemvri 2017 godina.

54 SHGM, “Sjellja e Kodeksit Etik të RTMV-së të shtyhet”, Shkup, viti 2017, <http://znm.org.mk/?p=3102>, qasur më 27 nëntor të vitit 2017.

B.4. Cili është niveli i pavarësisë redaktoriale të gazetarëve në sektorin jofitimprurës?

Në grupin e mediave jofitimprurëse vlerësohet se bien radiot që emetojnë më së shpeshti programe për të rinj, edhe atë në internet, si dhe mediat online të cilat merren kryesisht me storje huluntuëse dhe kryesisht ose tërësisht financohen nga ndihma donatore e bashkësisë ndërkombëtare.

Edhe pse numri i këtij lloji të mediave që merren me radiodifuzion është i vogël, në vitin 2017 ka patur vetëm tre media të tilla⁵⁵, megjithatë, së bashku me disa media online që merren me gazetari huluntuëse, vlerësohet se kanë më shumë pavarësi në përzgjedhjen e temave dhe mënyrën me të cilën do të raportojnë. Një pjesë e këtyre mediave kanë edhe storje të rregullta huluntuëse lidhur me tema nga sfera e korrupsionit, keqpërdorimit të pushtetit dhe ngjashëm.

Shumica e mediave informative online, janë të regjistruara si shoqata qytetare⁵⁶, respektivisht si organizata civile, por deri më tani, nuk është bërë analizë e detajuar për punën e tyre dhe për statusin e pavarësisë së gazetarëve në redaksitë e këtij lloji të mediave. Ajo që është e dukshme është se redaksitë e këtyre mediave janë shumë të vogla, dhe përfshijnë disa gazetarë që punojnë në bazë ditore, ndërsa financimi i tyre është jostabil, duke marrë parasysh se këto media varen nga ndihma ndërkombëtare që vjen në formë të donacioneve ose granteve.

Presioni ndaj këtyre mediave është zvogëluar dukshëm, krahasuar me presionin që ishte i pranishëm gjatë viteve të fundit, kur gazetarët dhe redaktorët e këtyre mediave, shpesh ishin pre e diskreditimit publik në bazë personale, dhe ndaj tyre përdorej gjuhë e urrejtjes, për shkak të kritikave të tyre publike ndaj pushtetit dhe biznesmenëve të afërt me Qeverinë.

55 Enti shtetëror për revision, publikim për veprimtarinë në radiodifuzion nga 31 maji i vitit 2018.

56 Pina.mk, “Prizma.mk; Nova TV; BIRN janë disa prej mediave më të nohura, që janë të regjistruara si organizata jofitimprurëse”.

B.5. Sa kanë liri gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?

Edhe këtë vit për shkak të ambientit të pasigurtë në të cilin punojnë gazetarët, e sidomos për shkak të politikës së mosndëshkimit, si dhe kushtet e këqija ekonomike në të cilat punojnë, gazetarët në mediat tradicionale, përfshirë këtu edhe RTVM-në, shumë rrallë përpunojnë tema të ndjeshme. Në programet informative të mediave kombëtare, thuajse nuk ka fare tema kritike të cilat janë jashtë kornizave të kronikave për ngjarje ditore politike. Por, ka një numër më të madh të debateve televizive në televizionet kombëtare. Megjithatë, ekziston përshtypja se nuk ka shumë llojshmëri të mysafirëve, pasi kryesisht paraqiten ekspertët e njëjtë, të cilët janë të afërt me qendra të ndryshme të fuqisë politike ose ekonomike. Ata janë ekspertë për gjithçka, dhe gazetarët i thërrasin të debatojnë për gjithçka, pavarësisht se për çfarë teme bëhet fjalë.

Zgjedhja e temave të raportimit në mediat lokale dhe rajonale, është edhe më problematike për gazetarët. Kjo për shkak të rrethit të vogël në të cilin funksionojnë këto mediave, dhe për shkak të lidhjeve të theksuara klienteliste të pronarëve të mediave me kryetarët e komunave, ose me personat e tjerë lokal që kanë fuqi.

Një gazetar i intervistuar nga servisi publik, që kërkoi të mbetet anonim, thotë: *“Profesionistët janë të marginalizuar, dhe ju jepen tema anësore, dhe kjo reflektohet edhe në përmbajtjen e programeve informative, siç janë lajmet, aktualiteti, programet e mëngjesit, madje edhe në emisionet kontaktuese me qytetarët”.*

Në mënyrë shtesë, sipas bashkëbiseduesit, në përmbajtjet e RTVM-së mbisundon anshmëria kah ish partia në pushtet, ndërsa kryesia e RTVM-së edhe në vitin 2018, mbetet e politizuar, dhe gjithë kjo reflektohet në përzgjedhjen e temave që përpunohen në servisin publik.

Situata në televizionet kombëtare nga tjetër, sa i përket temave, është më ndryshe. Edhe ato televizione që e përkrahnin fuqishëm VMRO DPMNE-në në politikën e saj, gjatë vitit të fundit kanë ndryshuar politikën redaktuese. Gjatë vitit të fundit, ata lëshojnë më shumë hapësirë për Qeverinë e re, ndërsa tek disa vërehet edhe drojë për mbështetje të VMRO-së, gjë që nuk ishte praktikë e mëparshme. Kjo është edhe një provë më shumë se gazetarët në këto media, madje nuk kanë patur as të drejtë për përzgjedhje të temave, por këtë e bëjnë redaktorët ose menaxherët e këtyre mediave. Shembull për këtë gjë është edhe deklarata e drejtorit të televizionit Kanal 5, dhënë më 5 gusht të vitit 2018, sipas të cilit, ai ka vendosur ndalesë për transmetim të informatave nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, dhe këtë e vlerëson si politikë redaktuese të vetë mediumit, e jo si presion ndaj informimit të lirë.



Siguria e gazetarëve dhe statistika e mosndëshkimit

Siguria e gazetarëve në Maqedoni, gjatë vitit 2018, është përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar. Edhe pse ende është e pranishme praktika e mosndëshkimit të dhunës ndaj gazetarëve. Numri i sulmeve fizike dhe kërcënimeve ndaj gazetarët është ulur në mënyrë drastike. Në periudhën nga shtatori i vitit 2017 deri në shtator të vitit 2018, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë ka regjistruar gjashtë sulme ndaj gazetarëve që krahasuar me vitin e mëparshëm kur kishte gjithsej 18 sulme, është për tre herë më pak.

Gjatë vitit të fundit, hetimet për sulmet ndaj gazetarëve policia i zhvillonte në mënyrë më efektive. Megjithatë politika e mosndëshkimit ka vazhduar, sidomos kur bëhet fjalë për sulme ndaj gazetarëve nga vetë pjesëtarë të policisë. Policia nuk i hetoi deri në fund rastet e arrestimit të tre gazetarëve në stacion policor, nën akuza se kanë fotografuar një gjykatës në sallën gjyqësore, dhe kanë fotografuar disa policë gjatë një proteste publike. Incidenti me arrestimin e një kameramani të TV 21 dhe një fotoreporterit nga Kosova, hyri edhe në raportin e OSBE-së për zgjedhjet lokale të mbajtura në dhjetor të vitit 2017⁵⁷. Ka një përmirësim të dukshëm në zhvillimin e hetimeve dhe procedurave gjyqësore për sulmet mbi gazetarët, nga ana e prokurorisë dhe gjyqësorit, por shumica e lëndëve ende janë të bllokuara në labirintet gjyqësore. Gjykata në Shkup dënoi një person me gjashtë muaj burg, për shkak të sulmit fizik ndaj të gazetari, ndërsa Gjykata

kundërvajtëse në Strugë, për të njëjtën vepër, pesë qytetarë i dënoi vetëm me gjobë, dënim me para. Të dy verdiktet nuk janë të plotfuqishme, pasi të dënuarit kanë bërë ankesë. Megjithatë, verdiktet e dhëna ndaj kryerësve të sulmeve janë shumë të rëndësishme, pasi me këtë gjest, është ndërprerë politika disavjeçare e mosndëshkimit të dhunës ndaj gazetarëve nga ana e institucioneve.

Edhe Komisioni Evropian e ka vërejtur uljen e presionit mbi gazetarët, si rezultat i ndryshimit të ambientit politik, dhe këtë e ka shënuar në Raportin mbi përparimin e Maqedonisë gjatë vitit 2018⁵⁸. Megjithatë, Komisioni vlerëson se nuk mjafton vetëm që pushteti ti regjistrojë dhe t'i dënojë sulmet, por se prokurori publik, duhet seriozisht t'i hetojë këto raste dhe t'i thirrë në përgjegjësi dhunuesit.

Ajo që shqetëson është se një numër i madh i rasteve të dhunës gjatë pesë viteve të fundit, nuk janë zbardhur, ose nuk janë trajtuar siç duhet. Kryesia e re e Ministrisë së Punëve të Brendshme ankohet se një numër i konsiderueshëm i lëndëve janë të bllokuara pasi nuk mund të gjenden autorët, meqë qeverisja e kaluar, i ka trajtuar hetimet mbi këto raste në mënyrë joprofesionale, dhe në disa raste mungojnë edhe prova⁵⁹.

57 Raporti final i OSBE-së për zgjedhjet lokale në tetor të vitit 2017, faqja 23. <https://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/372751?download=true> qasur më 5 shtator, viti 2018.

58 Komisioni Evropian, Shkup, 2018, <https://bit.ly/2qJP0Kv> qasur më 5 shtator të vitit 2018.

59 Toçka, "Spasovski: 15 raste të sulmeve ndaj gazetarët, nuk është vepruar në kohë qëllimisht" Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2QcXx4F> qasur më 28 shtator, viti 2018.

C.1.1. Sulme ndaj gazetarëve dhe kërcënime të tjera

Në vitin 2018, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë regjistroi gjashtë sulme mbi gazetarët. Krahasuar me vitin paraprak kur kishte 18 sulme, këtë vit, numri i sulmeve është zvogëluar për tre herë. Vitin e fundit kishte vetëm një sulm fizik ndaj një gazetari, një kërcënim verbal për jetë, dy arrestime të paligjshme nga ana e policisë, një incident në të cilin ishte shkatërruar prona e një gazetari, dhe një rast kur një fotoreporter është penguar që të raportojë nga një protestë publike, nga një zyrtar qeveritar.

Ajo që është pozitive këtë vit, është fakti se institucionet e ndërprejnë politikën e mosndëshkimit të dhunës ndaj gazetarëve, që zgjati thuhetse 10 vite. Gjykatat e Maqedonisë në këtë periudhë, kanë sjellë dy verdikte me të cilat sulmuesit e gazetarëve dënohen me dënime me burg ose me gjoba në para.

Gjykata Themelore Shkupi 1, në shtator të këtij viti, e dënoi me gjashtë muaj burg, personin Matija Kanikov, i cili gjatë shkurtit të vitit të kaluar, pas mbarimit të protestës së Lëvizjes “Për Maqedoni të përbashkët”, kundër formimit të Qeverisë së re, i ka sulmuar fizikisht kameramanin dhe gazetarin e portalit A1 On, Alesandar Todevski dhe Vladimir Zhellçevski. Pas një muaji, policia e zbardhi rastin dhe ngriti kallëzim penal kundër Kanikovit⁶⁰, ndërsa në shtator të këtij viti, gjykata e dënoi me burg⁶¹. Mbrojtja paralajmëroi ankesë ndaj vendimit, dhe tani pritet vendimi i Gjykatës së Apelit.

Institucionet zhvilluan procedurë efikase edhe në rastin e gazetarit Armand Braho nga Struga, i cili në janar të vitit 2018, ishte sulmuar fizikisht nga aktivistë të partisë opozitare, Aleanca për Shqiptarët e Zijadin Selës, që kanë dashur ta pengojnë në raportimin e tij gjatë tubimit parazgjedhor të kësaj partie⁶². Policia i identifikoi sulmuesit shpejtë, dhe ndaj tyre ngriti kallëzim penal para Gjykatës kundërvajtëse në Strugë. Pas gjashtë muajsh, gjykata i shpalli fajtorë sulmuesit e Brahos, dhe i dënoi me gjoba në para. Këtë vendim, mbrojtja e ka ankimuar.

Vlen të theksohet edhe praktika pozitive e Qeverisë së re, e cila gjatë periudhës së kaluar, publikisht i dënonte sulmet ndaj gazetarëve dhe bënte thirrje deri tek institucionet kompetente që ti dënojnë dhunuesit⁶³. Sulmet ndaj gazetarëve ishin dënuar publikisht edhe nga ana e kryeministrit Zoran Zaev, ministrit të brendshëm Oliver Spasovski si dhe nga ana e funksionarëve qeveritar.

Ajo që shqetëson më së shumti lidhur me sigurinë e gazetarëve gjatë vitit 2018, është fakti se policia në mënyrë arbitrare, arrestoi disa gazetarë dhe me këtë, i pengoi në kryerjen e detyrave të tyre profesionale.

Incidenti më serioz me gazetarë, i shkaktar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndodhi në nëntor të vitit 2017, kur pjesëtarë të policisë e arrestuan kameramanin e Televizionit 21 Ibrahim Mahmuti, dhe fotoreporterin nga Kosova, Blerim Uka⁶⁴. Ata ishin mbajtur në stacion më shumë se gjashtë orë, nën akuza se gjatë kumtimit të verdiktit për rastin “Kumanova”, në gjykatë, e kanë fotografuar gjykatësen⁶⁵.

Menjëherë pas arrestimit të gazetarëve, përfaqësues të SHGM-së kërkuan personalisht përgjigje nga udhëheqësit e stacionit policor, por, asnjë prej personave përgjegjës nuk dëshoi të ju japë informata, e as të bisedojë me ta. Të dy gazetarët u liruan pas intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare, ndërsa një përfaqësues i OSBE-së bisedoi me personat përgjegjës në stacionin policor.

Pas lirimit, gazetarët e njoftuan SHGM-në se gjatë marrës në pyetje, inspektorët nuk i kanë pyetur vetëm për gjoja incizimin e gjykatëses gjatë shpalljes së verdiktit për rastin “Kumanova”, por edhe për krejtësisht çështje të tjera me karakter të sigurisë. Pas këtij incidenti, policia nuk ngriti asnjë procedurë kundër pjesëtarëve të saj për shkak të arrestimit të gazetarëve.

60 SHGM, “MPB e zbardhi rastin e sulmit ndaj gazetarëve të A1 On”, Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/?p=3119>

61 SHGM, “Përhëndetet dënimi me burg për sulmuesin e portalit A1 On”, Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/?p=4663>

62 SHGM, “Dënim për sulmin ndaj gazetarit në Strugë”, Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/?p=4196>

63 Qeveria, “Reagim lidhur me kërcënimin ndaj kryetarit të SHGM-së Naser Selmani”. Shkup, 2018, <http://vlada.mk/?q=node/14224> qasur më 25 korrik të vitit 2018.

64 SHGM, “SHGM e dënon arrestimin e gazetarëve nga ana e policisë”, Shkup, 2017. <http://znm.org.mk/?p=3866>.

65 SHGM, “SHGM e dënon arrestimin e gazetarëve nga policia”, Shkup, 2017, <http://znm.org.mk/?p=3866>.

Një incident më të lehtë me gazetar, policia shkaktoi në qershor të këtij viti, gjatë protestave kundër marrëveshjes me Greqinë, para Parlamentit, kur gazetari i portalit Infomaks Borislav Stoilkoviç u arrestua, me arsyetimin se i ka filmuar policët në fytyrë dhe ka refuzuar që të legjitimohet⁶⁶.

SHGM-ja e dënoi praktikën e arrestimit arbitrar nga ana e policisë, duke kujtuar se me asnjë ligj, nuk është i ndaluar filmimi i policëve gjatë protestave, pasi është me interes publik që të informohet për veprimet eventuale joligjore të policisë ndaj protestuesve⁶⁷. Përveç kësaj, SHGM e hodhi poshtë argumentin e policisë se gazetari ka refuzuar të legjitimohet, kur ai ka patur akreditim gazetari në vend të dukshëm.

Edhe pse SHGM-ja bëri thirrje për përgjegjësi për arrestimin e gazetarëve, MPB-ja refuzoi që të zhvillojë hetim, pasi vlerëson se nuk ka patur asnjë shkelje të procedurave ose pengesë mbi punën e gazetarëve.

Gjatë vitit të fundit, ndodhi edhe një incident në të cilin ishte dëmtuar makina e një gazetari. Në shtator të vitit 2017, gazetarja e javores Fokus Viki Klinçarova, u ankua se ka patur kërcënime nga një mjedis kriminel, dhe një ditë më pas, i ishte dëmtuar makina.⁶⁸ Ky rast nuk është hetuar, edhe pse pati reagime nga SHGM-ja dhe raportim nga ana e mediave.

Policia ka vendosur një praktikë të keqe sipas të cilës, rastet që nuk janë denoncuar, trajtohen sikurse të mos kenë ndodhur fare, pavarësisht nëse për to ka patur informata dhe reagime në opinion. Sulmi i fundit ndaj ndonjë gazetari ka ndodhur në korrik të këtij viti, kur një funksionar i Qeverisë, pengoi fotoreporterët gjatë raportimit të tyre nga një ngjarje publike, dhe madje edhe i ka ofenduar.⁶⁹ Shefi i Shërbimit për marrëdhënie me publik në Qeveri, Marjan Zabrčanec, i ka penguar reporterët që ta fotografojnë kryeministrin Zoran Zaev, gjatë takimit të liderëve, për shkak të arsyeve të sigurisë. Pas incidentit, Zabrčanec i thirri në takim fotoreporterët dhe u kërkoi falje publike.

C.1.2. Vrasje të gazetarëve dhe ngjarje gjatë 15-20 viteve të fundit

Në dhjetë vitet e fundit në Maqedoni, kanë humbur jetën dy gazetarë, në rrethana tejet të paqarta dhe të çuditshme. Hetimi zyrtar thoshte se bëhet fjalë për vetëvrasje, respektivisht për aksident trafiku.

Ngjarja e parë tragjike ndodhi në vitin 2008, kur gazetari i gazetës "Utrinski Vesnik", Vlado Tanevski, i dyshuar për një seri vrasjesh në Kërçovë, gjoja se është vetëvrasur në burgun e Tetovës. Sipas raportit të autoposisë, ai është mbytur në qelinë e tij, duke u ngulfatur në një kovë. Ky raport i obduksionit hapi shumë debate në opinion, për shkak të shpjegimit të palogjikshëm se si ka mundësi që një njeri të vetëvritet me kovë, por reagime zyrtare lidhur me këtë rast kontrovers nuk ka patur asnjëherë⁷⁰.

Rasti i dytë tragjik ndodhi në vitin 2013, kur gazetari dhe pronari i javores "Fokus", Nikolla Mladenov⁷¹, humbi jetën në një aksident tragjik në afërsi të Shkupit. Hetimi zyrtar konstatoi se bëhet fjalë për fatkeqësi dhe i mohonte dyshimet në opinion se bëhet fjalë për vrasje⁷². Opozita e atëhershme LSDM, hodhi dyshime mbi vërtetësinë e hetimit zyrtar dhe publikonte informacione se gjoja aksidenti i Nikolla Mladenovit, nuk ka qenë një aksident⁷³. Përveç kësaj, SHGM kërkoi edhe një hetim të pavarur, me qëllim që të konstatohet saktë se në çfarë rrethana ka vdekur gazetari⁷⁴.

66 Pres24, "Video: Në protestat e djeshme u arrestua një gazetar – policia e tërhiqte drejt makinës", Shkup, 2018, <https://bit.ly/2NvoUs5> qasur më 24 korrik të vitit 2018.

67 SHGM, "Dënim për sulmet ndaj gazetarëve gjatë protestës para Kuvendit", Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/?p=4486>.

68 SHGM, "Dënim për dëmtimin e makinës së gazetares Klinçarova", Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/?p=3733>.

69 SHGM, "Dënojmë incidentin me fotoreporterët në Klubin e deputetëve", Shkup, viti 2018, <http://znm.org.mk/?p=4552>.

70 Veçer, "Si arriti të vetëvritet në kovë?!", Shkup, 2008, <https://vecer.mk/kakouspeal-da-se-udavi-vo-kofa>. Qasur në shtator të vitit 2018.

71 MKD.MK, "Gazetari i njohur Nikolla Mladenov humbi jetën në një aksident rrugor", Shkup, viti 2013, <https://bit.ly/2Mw3UwR>. Qasur në shtator të vitit 2018.

72 Evropa e Lirë, "Prokuroria: Vdekja e Nikolla Mladenovit-aksident", Shkup, viti 2013, <https://bit.ly/2Mu29QM>. Qasur në shtator të vitit 2018.

73 Faktor, "Opozita me të dhëna shokuuese për vdekjen e Nikolla Mladenovit", Shkup, viti 2013, <https://bit.ly/2OoLBLE>. Qasur në shtator të vitit 2018.

74 SHGM, viti 2015, <http://www.znm.org.mk/drupal-77/mk/node/887>, Qasur në shtator të vitit 2018.

C.1.3. Presion ndaj mediave, esnafëve dhe organizatave mediatike

Gjatë periudhës për të cilën është shkruar raporti, kishte një kërcënim me vdekje të drejtuar ndaj gazetarit dhe kryetarit të SHGM-së Naser Selmani. Kërcënimet vinin nga një familjar i afërt i një funksionari lokal i BDI-së në Shkup. Naser Selmanin dhe familjen e tij, e kërcënoi me jetë vëllai i Beqir Asanit, nga profili i tij në Fejsbuk. Kërcënimet erdhën pasi Selmani në rrjetet sociale e dënoi sjelljen e dhunshme të Beqir Asanit ndaj polices e cila kishte dashur ti shkruajë dënim për parkim të parregullt.

Për shkak të këtyre kërcënimeve brutale, dhe reagimit të vakët nga pushteti, shoqëria e gazetarëve organizoi protesta para Qeverisë⁷⁵, dhe u kërkoi institucioneve, që tu japin fund kërcënimeve dhe presioneve ndaj gazetarëve. Ky sulm ishte dënuar menjëherë edhe nga Qeveria edhe nga faktori ndërkombëtar. Përfaqësuesi i lartë i OSBE-së për lirinë e mediave Harlem Dezir, i dënoi kërcënimet dhe iu bëri thirrje institucioneve që ta hetojnë rastin.

Rasti u denoncua menjëherë në polici, e cila mori masa në kuadër të aktiviteteve të saj. Megjithatë, Prokuroria Publike në Shkup, refuzoi që të nisë hetim pasi ka vlerësuar se nuk ka patur kërcënim në mesazhin e shkruar. Pas reagimeve në opinion, prokurorja Spasenka Andonova hapi hetim dhe u bëri thirrje të dy palëve që të japin deklaratë. Pas gjashtë muajsh, prokurorja Andonova nuk ka ngritur akuzë kundër vëllait të Beqir Asanit, Bejtulla Asani.

75 DW, "Protestë e gazetarëve para Qeverisë? Lidhni qentë tuaj!", Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2CBKRTt>, Qasur në shtator të vitit 2018.

C.2.1. A marrin politikanët dhe institucionet shtetërore masa të veçanta me të cilat mbrohen gazetarët

Qeveria e re e cila është formuar në qershor të vitit 2017, shpalli zero tolerancë ndaj dhunës mbi gazetarët. Një prej pikave kyçe në planin reformues 3-6-9⁷⁶, ishte pikërisht lufta kundër politikës së mosndëshkimit⁷⁷.

Plani parashikonte që Ministria e Brendshme të përgatisë një raport për të gjithë sulmet ndaj gazetarëve. Raporti⁷⁸ ishte publikuar në muajin maj të këtij viti, ndërsa nga rezultatet ishte e qartë se ekziston politikë e qartë e mosndëshkimit të dhunës ndaj gazetarëve.

Nga 59 sulmet mbi gazetarët që kanë ndodhur gjatë pesë viteve të fundit, policia deri më tani ka zbardhur vetëm shtatë, me kallëzime penale kundër autorëve. Sipas raportit, policia deri më tani nuk ka arritur në mënyrë të plotë të zgjidhë 13 lëndë për sulme ndaj gazetarëve, ndërsa dhjetë raste të tjera i trajton si të zgjidhura, pasi i ka paralajmëruar sulmuesit me shkrim.

Për tetë sulme, policia e ka mbaruar hetimin dhe ka parashtruar kërkesë për ngritjen e procedurë kundërvajtëse, ndërsa për po kaq lëndë, ka dorëzuar informatë në prokurori.

76 Qeveri, "Plani 3-6-9", Shkup, vitit 2017, <https://bit.ly/2Mqi2l1>, qasur në shtator të vitit 2018.

77 Makfaks, "Popovski: Çdo sulm fizik ose verbal ndaj gazetarëve do të sanksionohet", Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2Ni3wA0>, qasur në shtator të vitit 2018.

78 Makfaks, "Spasovski: 15 raste të sulmit ndaj gazetarëve, nuk është vepruar qëllimisht", Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2xjvpUC>, qasur në shtator të vitit 2018.

Shtatë lëndë, policia i konsideron si të zgjidhura, pasi ka i ka udhëzuar gazetarët që ti mbrojnë të drejtat e tyre duke ngritur padi private. Në raport nuk ka të dhëna nëse policia i ka identifikuar sulmuesit dhe ka siguruar prova që do ti vente në dispozicion të viktimave, me qëllim të zhvillimit sa më efikas të gjyqimit.

Për dy lëndë, në pamundësi që ti gjejë sulmuesit, MPB ka ngritur kallëzim penal kundër personave të panjohur, ndërsa në dy raste, e ka mbyllur procedurën pasi ka vlerësuar se nuk ka elemente për nisjen e hetimit.

Prej rasteve të sulmit ndaj gazetarëve që janë zbardhur tërësisht, e për të cilat policia ka ngritur kallëzime penale, shumica kanë të bëjnë me sulme fizike ndaj gazetarëve, ndërsa një incident ka të bëjë me dëmtimin e pronës dhe kërcënimin serioz. Policia e ka zbuluar sulmuesin e pronarit të portalit Dokaz, Marjan Stamenkovski, i cili në vitin 2015 në qendrën e Shkupit, ishte sulmuar fizikisht, me çka kishte marrë lëndime të rënda trupore. Është zbuluar edhe sulmuesi i ekipit të portalit A1 On, që ishte sulmuar fizikisht nga një protestues i Lëvizjes “Për Maqedoni të përbashkët”

Prej 13 rasteve të pazbardhura për sulme ndaj gazetarëve, shumica kanë të bëjnë me sulme dhe kërcënime dhe shkatërrim të pronës. Të pazbuluara kanë mbetur sulmet fizike dhe shkatërrimi i pajisjeve të disa gazetarëve nga protestues të Lëvizjes “Për Maqedoni të përbashkët”, të cilët më 27 prill kanë hyrë me dhunë në Parlament, për ta penguar formimin e Qeverisë së re. Policia nuk arriti që ti zbulojë as ata që në vitin 2015, ia vënë flakën xhipit të gazetarit Branko Triçkovski.

Është e paqartë përse policia nuk mund të zbardhë sulmin ndaj gazetarit Borjan Jovanovski i cili ishte pështyrë dhe ofenduar në një restorant, ndërsa i gjithë rasti ishte filmuar dhe vendosur në Youtube. Njërin prej sulmuesve, Jovanovski e njohu në një konferencë të ish kryeministrit Nikolla Gruevski, por policia nuk u interesua për këtë pohim.

Është e paqartë përse policia e trajton si të pazgjidhur rastin e përjashtimit me dhunë të një gazetari lokal në seancë të Komunës Berovë, që e kishin përjashtuar këshilltarët. Gazetari e ka njoftuar policinë dhe ia ka treguar identitetin e këshilltarëve, por policia këtë rast ende e trajton si të pazgjidhur.

Në pamundësi për ti gjetur sulmuesit e të dy gazetarëve, policia ka ngritur kallëzim penal kundër personave të panjohur. Ky rast është edhe me gazetarin e Ohrit i cili ishte sulmuar nga persona të panjohur me shufra hekuri, që i kishin shkaktuar lëndime të rënda trupore.

Në tetë raste, policia ka dorëzuar kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse. Kjo do të thotë se procedura është ende në fillim, edhe pse kanë kaluar vite të tëra prej kur kanë ndodhur këto raste. Por vlen të theksohet se policia nuk është konzistente në kualifikimin e veprave kur sulmohen gazetarët. Për arsye të paqarta, policia këto raste në situata të tjera i trajton si vepra penale, ndërsa në raste të tjera si kundërvajtje.

Katër sulme nga lëndët për të cilat janë ngritur kallëzime penale, kanë të bëjnë me raste të sulmit fizik ndaj gazetarëve. Në dy prej këtyre rasteve, gazetarëve u janë shkaktuar lëndime të dukshme trupore. Këto sulme më të rënda, trajtohet njëllë sikurse sulmet e tjera kur gazetarët janë goditur me shuplakë ose janë kërcënuar se do të sulmohen fizikisht.

Policia nuk e ka çuar punën deri në fund, edhe në tetë lëndë të tjera, kur pas mbarimit të hetimit, në vend që të ngrëjë kallëzime adekuate, ka dorëzuar vetëm një njoftim deri tek prokuroria publike. Kjo mund të interpretohet si tentativë e policisë për t'i mënjanuar lëndët, me qëllim që ti humb nëpër labirintet policore dhe prokuroriale,

Një prej këtyre lëndëve është edhe rasti i një polici i cili në vitin 2016, e ka rrahur një gazetar me shkop policie. Rasti ka ndodhur gjatë protestave kundër faljes së funksionarëve të lartë të VMRO DPMNE-së të akuzuar për krim, para zyrës së kryetarit Gjorge Ivanov, në qendër të Shkupit. Në mënyrë shtesë, është konstatuar se polici i ka tejkalluar autorizimet, megjithatë policia ka refuzuar që të ngrëjë kallëzim kundër tij. Vetëm e ka njoftuar prokurorinë e cila nuk ka ndërmarrë asgjë lidhur me këtë rast deri më tani.

Policia ka vepruar ngjashëm edhe në lëndën e gazetarit Borjan Jovanovski, të cilit, në vitin 2015, persona të panjohur i vendosën një kurorë lulesh për vdekje para shtëpisë së tij. Edhe sulmi ndaj gazetarit të Zërit të Amerikës Isak Ramadani, përfundoi vetëm me njoftim deri në prokurori. Ramadani në vitin 2014 morri shuplakë nga një pjesëmarrës në protestat kundër rastit “Monstra”, para gjykatës penale. Por, policia nuk mundi që ta zgjidhë këtë rast, edhe pse sulmuesi e kishte goditur gazetarin para kamerave dhe para shumë dëshmitarëve. Policia dhe prokuroria deri më tani, nuk kanë ngritur kallëzim për asnjë rast të denoncuar të gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale kundër gazetarëve.

Ndonjëherë, ofendimet ndaj gazetarëve, kërcënimet e madje edhe kërcënimet me vdekje, policia i trajton vetëm me paralajmërim gojor ose me shkrim të dhunuesve. Në këtë mënyrë policia vlerëson se ka zgjidhur dhjetë lëndë të sulmeve verbale dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Vetëm paralajmërim ka marrë edhe personi që në vitin 2015, me kërcënim fizik, e ka dëbuar nga një restorant gazetarin Borjan Jovanovski, për shkak të kritikave të tij ndaj pushtetit të kaluar. Edhe sigurimi privat në Qendrën Tregtare në Shtip që pati penguar një gazetar të televizionit 24 që të filmojë punimet e ndërimit, dhe ia pati thyer kamerën, kaloi vetëm me qortim gojor dhe paralajmërim.

Shtatë sulme ndaj gazetarëve, policia i ka zgjidhur me atë sygjerim për gazetarët e dëmtuar që ti mbrojnë të drejtat e tyre duke ngritur padi private kundër sulmuesve. Këto lëndë kanë të bëjnë me kërcënime dhe ofendime ndaj gazetarëve, si dhe shkatërrim të pronës së tyre. Në dy raste të sulmit ndaj ndonjë gazetari, policia nuk, policia nuk ka hapur hetim pasi që ka vlerësuar se nuk ka prova të mjaftueshme. Ekziston një rast interesant i një gazetari nga Shkupi i cili është arrestuar në mënyrë të paligjshme nga sigurimi privat në një supermarket, gjoja se ka dyshuar për vjedhje. Pasi policia e ka hetuar rasatin, ka konstatuar se gazetari nuk ka vjedhur asgjë nga supermarketi, por sigurimit privat nuk ia ka ngritur asnjë procedurë.

C.2.2. A ekzistojnë mekanizma të veçanta nëpërmjet të cilave ndiqen sulmet ndaj gazetarëve?

Në Maqedoni, nuk ka mekanizma të veçanta për ndjekje dhe njoftim mbi sulme e kërcënime ndaj gazetarëve. Të gjithë institucionet si policia, prokurori e gjykata, kanë dhënë zotim për të luftuar praktikën e mosndëshkimit të dhunës ndaj gazetarëve, por ende hetimet zhvillohen në mënyrë tejet të ngadalshme. MPB pranon publikisht se shumica e rasteve nuk mund të zbardhen fare, për shkak të hetimeve të mangëta që janë zhvilluar gjatë qeverisjes së mëparshme pasi ka patur edhe raste ku janë shkatërruar prova. SHGM insiston që policia t'i thirrë në përgjegjësi pjesëtarët e saj që kanë vepruar në mënyrë joprofesionale dhe antiligjore.

Bazuar në raportet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe Prokurorisë Publike, vërehet një dukuri negative gjatë zhvillimit të hetimit për sulmet mbi gazetarët. Këto dy institucione akuzojnë njëra tjetrën për zvarritjen e proceseve. Policia nga njëra anë, pohon se ka zgjidhur shumë raste dhe ato ia ka dorëzuar prokurorisë, ndërsa nga prokuroria pohojnë se policia nuk i ka identifikuar sulmuesit dhe nuk ka siguruar prova të mjaftueshme për zhvillim efikas të hetimit.

Në Maqedoni, asnjë institucion shtetëror nuk mban ndonjë regjistër të sulmeve ose kërcënimeve ndaj gazetarët. Përveç kësaj, me përjashtim të policisë, prokuroria dhe gjykata kryesisht janë të mbyllura në aspekt të shpërndarjes së informatave për lëndët e sulmeve mbi gazetarët. Përkundër insistimeve të shumta, Prokuroria madje pas 2 muajsh, i dorëzoi SHGM-së disa informata gjysmake për procedurat që zhvillohen në këtë institucion. Ndërsa Gjykata Penale, edhe këtë vit nuk na dha informacione mbi veprimet që i ka ndërmarrë lidhur me sulmet ndaj gazetarëve, duke u arsyetuar me formalitete.

Vetëm Shoqata e Gazetarëve mban regjistër të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, i cili është i qasshëm publikisht në ueb faqen e Shoqatës⁷⁹.

C.2.3. A i njohin institucionet qeveritare sulmet ndaj gazetarëve?

Qeveria deklarativisht i dënon të gjithë incidentet dhe sulmet ndaj gazetarëve⁸⁰. Kryeministri Zoran Zaev dhe funksionarë të tjerë të lartë, rregullisht i dënojnë këto sulme dhe u bëjnë thirrje organeve të rendit që ti hetojnë dhe ndëshkojnë sulmuesit.

79 SHGM, "Raste të shkeljes së të drejtës së gazetarëve – korrik viti 2018", Shkup viti 2018. http://znm.org.mk/?attachment_id=4643, qasur në shtator të vitit 2018.

80 Qeveria, "REagim lidhur me kërcënimin ndaj kryetari të SHGM-së Naser Selmani", Shkup, 2018, <http://vlada.mk/?q=node/14224>, qasur në shtator të vitit 2018.

Institucionet më të rëndësishme në vend për udhëheqjen e hetimeve efektive për sulmet ndaj gazetarëve, siç është për shembull policia, prokuroria dhe gjykata, nuk bëjnë dallim mes sulmit ndaj gazetarëve dhe sulmit ndaj qytetarëve të thjeshtë. Nga bashkëpunimi i deritanishëm me ta, është e qartë tendenca që sulmet ndaj gazetarëve, të njëjtësohen me sulme ndaj qytetarëve të tjerë. Ata aspak nuk i llogarisin këto sulme si sulme ndaj lirisë së shprehjes dhe sulm ndaj demokracisë në përgjithësi.

C.2.4. A ekzistojnë dokumente në kuadër të policisë ose ushtrisë, që shërbejnë si udhëzues në raste kur janë cenuar të drejtat e gazetarëve?

Deri më tani, ushtria dhe policia nuk kanë miratuar dokumente me të cilat do ti trajnonin pjesëtarët e tyre se si të sillen me gazetarët. Këto institucione nuk kanë as rregullore me të cilat ndalojnë kërcënimet, frikësimet ose sulmet ndaj gazetarëve.

C.2.5. A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat dhe esnafet e gazetarëve, lidhur me sigurinë e gazetarëve?

Pushteti i ri në Maqedoni tregoi një gatishmëri më të madhe për të bashkëpunuar me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë, për të zbardhur të gjithë sulmet ndaj gazetarëve. Ministria e Punëve të Brendshme, në dhjetor të vitit 2017, nënshkroi Memorandum me SHGM-në me të cilin parashikoheshin aktivitete të përbashkëta për ndërprerjen e politikës së mosndëshkimit për sulmet ndaj gazetarëve⁸¹.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, SHGM dhe MPB, me ndihmë edhe të Zyrës së OSBE-së në Shkup, organizuan trajnime të përbashkëta për gazetarëve dhe pjesëtarë të policisë, për raportim gjatë ngjarjeve të krizës, siç janë protestat ose hetimet. Dy trajnime⁸² u

organizuan në Shkup, dhe pesë në qytetet e tjera më të mëdha. Trajnimet e përbashkëta kanë për qëllim njoftimin e ndërsjellë dhe publikimin e një Udhëzuesi për gazetarët dhe policinë për raportim nga ngjarjet e krizës, që ende është në përpunim.

Në tentativë për të ndërprerë politikën e mosndëshkimit për dhunën ndaj gazetarëve, përfaqësues të SHGM-së në janar të këtij viti, u takuan me prokurorin publik të Maqedonisë Lubomir Joveski⁸³. Në takim, përfaqësuesit e SHGM-së kërkuan nga prokurori që ti hetojë në mënyrë më efektive sulmet ndaj gazetarëve. U dakordua që të organizohen trajnime të përbashkëta për njoftim më të mirë dhe informim për rëndësinë e lirisë së mediave në një shoqëri demokratike.

Kësi trajnimi⁸⁴ ishte organizuar në shkurt të vitit 2018. Ish gjykatësja në Gjykatën Evropiane në Strasburg, Mirjana Trajkovska, mbajti ligjërata para prokurorëve dhe gazetarëve, lidhur me praktikën e GJETN, për lirinë e shprehjes. Prokurorja Ivana Trajçevska ka prezantuar rezultate nga hetimet lidhur me sulmet ndaj gazetarëve.

C.2.6. Cili është rasti i fundit i përgjimit jolegal dhe ndjekjes së gazetarëve, dhe si institucionet shtetërore ballafaqohen me këtë gjë?

Përveç aferës së madhe të përgjimit nga viti 2015, kur qindra gazetarë ishin në listën e përgjimit nga policia sekrete, SHGM nuk ka informacione se në vitin 2018, dikush ka qenë pre e përgjimit të paligjshëm nga pushteti. Kontesti gjyqësor që SHGM e ngriti në emër të gazetarëve të përgjuar, është ende në fillim, pasi fillimisht duhet të silltet vendimi se përgjimi ka ekzistuar, dhe pas mund të kërkohet edhe dëmshpërbllim nga shteti.

81 A10n, "SHGM dhe MPB nënshkruan Memorandum për bashkëpunim", Shkup, viti 2017, <https://a10n.mk/archives/838401>, qasur në shtator të vitit 2018.

82 SHGM, "Ti vihet fundi politikës së mosndëshkimit, të ndëshkohen dhunuesit", Shkup, viti 2018, <https://znm.org.mk/?p=4370>, qasur në shtator të vitit 2018.

83 SHGM, "Përfaqësues të SHGM-së u takuan me Prokurorin Publik", Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/?p=4173>, qasur në shtator të vitit 2018.

84 SHGM, "SHGM organizoi trajnim për gazetarë, avokatë dhe prokurorë publik", Shkup, 2018, <http://znm.org.mk/?p=4221>, qasur në shtator të vitit 2018.

C.3. Si ballafaqohet gjyqësori me çështjet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj gazetarëve?

Në Maqedoni, hetimet e prokurorisë dhe gjyqësorit lidhur me dhunën ndaj gazetarëve, janë joefektive dhe joefektive. Veprimi i tij ndiqet shumë rëndë, pasi që të dy institucionet janë shumë të mbyllura.

Gjykata Themelore në Shkup tashmë dy vite me radhë, kundërshton që të japë informata lidhur me fazën e veprimit për rastet ku gazetarët janë viktime. Arsyetimi i tyre është se sistemi për menaxhim me lëndët (AKMIS) bazohet në kode e jo në emra ose në profesione të palëve. PAS dy muaj, nga momenti i dorëzimit të kërkesës për informatë dhe pas urgjencave të njëpasnjëshme, Prokuroria e Shkupit shpërndau disa informata të pjesshme lidhur me hetimet që kanë të bëjnë me gazetarët. Prej 59 sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, sipas regjistrimit të MPB-së, Prokuroria në Shkup zhvillon hetim vetëm për dhjetë lëndë, ndërsa nuk ka informatë për pesë lëndë të tjera që zhvillohen në Prokurorinë e Ohrit.

Rezultatet nga Raporti i Prokurorisë për hetimet që janë zhvilluar, nuk janë tejet inkurajuese. Prej dhjetë lëndëve të hapura, në katër raste Prokuroria i ka hedhur poshtë kallëzimet penale, pasi sipas vlerësimit të tyre, nuk bëhet fjalë për cenim të sigurisë, pra nuk përndiqet në bazë të detyrës zyrtare, por me padë private.

Pesë lëndët e tjera janë ende në fillim të hetimit, edhe pse një prej sulmeve ka ndodhur para katër vitesh, ndërsa tjetri para dy vitesh. Prokuroria pohon se ende po punon në vërtetimin e identitetit të sulmuesve dhe mbledhjen e provave të besueshme. Në dy lëndë, policia madje nuk ka vepruar edhe pse ka patur kërkesë nga Prokuroria, për ti identifikuar sulmuesit. Vetëm në një lëndë, hetimi është në fazë të avancuar, ku sulmuesi është identifikuar nga policia, ndërsa prokuroria punon në konstatimin e gjendjes faktike, pas çka do të pasojë vendimi i prokurorit.

Si vërtetim për mos efikasitetin e veprimeve të prokurorisë dhe gjyqësorit janë dy lëndët gjyqësore, kundër dy gazetarëve, Zoran Bozhinovski dhe Tomisllav Kezharovski, të cilët për vite me radhë janë pre e përndjekjes politike. Gjykata Supreme tashmë tre vite me radhë, nuk merr vendim lidhur me ankesën e Kezharovskit, i cili në vitin 2014, ishte dënuar me 4 vite e gjysmë burg, për gjoja zbulim të identitetit të një dëshmitari të mbrojtur. Gjykata e Apelit e vërtetoi verdiktin, por e uli dënimin me burg në dy vite, por pastaj mbrojtja dorëzoi ankesë deri tek Gjykata Supreme.

Fatin e njëjtë e kishte edhe rasti kundër Bozhinovskit i cili në vitin 2013, ishte akuzuar për spiunim, bashkim kriminel dhe shantazh, dhe deri më sot, ende nuk ka vendim të shkallës së parë, pasi rasti i tij për shkaqe formale, vazhdimisht anulohet, meqë Prokuroria nuk ka prova serioze. Në korrik të vitit 2017, ai u liria, pas 15 muajsh të kaluara në burg. Gjatë verës, Prokuroria Speciale⁸⁵ u tërhoq nga një pikë e aktakuzës kundër Bozhinovskit, por procesi gjyqësor vazhdon ende.

Në shtator, Prokuroria e tërhoqi akuzën për bashkim kriminel⁸⁶ për shkak të vjetërsimit të veprës, ndërsa po të njëjtin muaj, u tërhoq edhe akuzat për dhënien e sekretit shtetëror⁸⁷ pasi që kjo vepër penale, nuk ka qenë e theksuar në kërkesën për ekstradimin e tij nga Serbia.

85 SHGM, "PSP nuk do ta përndjekë Bozhinovskinin për dhënien të sekretit shtetëror", Shkup, viti 2018, <http://znm.org.mk/?s=%D0%A1%D0%88%D0%9E>, qasur në shtator të vitit 2018..

86 Fokus, "Zoran Bozhinovski nuk do të përndiqet për bashkim kriminel në "Spiuni", Shkup, 2018, <https://bit.ly/2N12VEZ>, qasur në shtator të vitit 2018..

87 MKD.MK, "PSP nuk do ta përndjekë gazetarin Bozhinovski për dhënien të sekretit shtetëror", Shkup, viti 2018, <https://bit.ly/2Q015WW>, qasur në shtator të vitit 2018.

Ekspertët mediatik të cilët u intervistuan për qëllimet e këtij raporti, vlerësojnë se zotimi i Qeverisë dhe institucioneve për ti dhënë fund politikës së mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve, për fat të keq, ende është vetëm deklarativ. Profesoresha e të drejtës mediatike Snezhana Trpevska pohon se refuzimi i policisë që ti përndjekë penalisht zyrtarët policor që kanë bërë hetime joprofesionale dhe kanë shkatërruar prova, vetëm e vazhdon praktikën e mosndëshkimit. “Kjo shkakton dëshpërim tek gazetarët nga mënyra se si institucionet sillen ndaj profesionit të tyre”, thekson Trpevska. Sipas saj, nëse institucionet zhvillojnë procedura efektive kundër sulmuesve, gazetarët do të ndjehen të mbrojtur, më të lirë dhe më lojal ndaj standardeve profesionale.

Edhe Marina Tuneva, drejtoresha e Këshillit të Etikës në media të Maqedonisë, vlerëson se institucionet duhet ta ndryshojnë qasjen ndaj politikës së mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve, “Secila tentativë për t’iu shmangur përgjegjësisë, mund të interpretohet si kultivim i një bazamenti të volitshëm për dhunë ndaj gazetarëve, në çfarëdo lloj forme”, thotë Tuneva. Ajo vlerëson se qasja joprofesionale e institucioneve ndaj dhunës mbi gazetarët, i kufizon dhe frustron gazetarët pasi që ata ballafaqohen me një realitet të ashpër, tipik për shoqëritë e robëruara.

C.3.1. A ekzistojnë institucione specifike të cila merren me hetime kur cenohen të drejtat e gazetarëve?

Në sistemin gjyqësor-prokurorial në Maqedoni, nuk ekzistojnë reparte të veçanta të cilat merren me hetime të rasteve të përndjekjes, mbrojtjes ose dëmshpërblimit të gazetarëve, me qëllim që tu ofrohet siguri, dhe në mënyrë që të pengohet politika e mosndëshkimit. Veprime speciale nuk zbatohen as në raste kur viktima të sulmit janë gazetarë. Gjyqësori dhe prokuroria, asnjëherë nuk janë ankuar se hetimet e tyre për rastet e gazetarëve janë të vaktës, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe materiale.

Për sulmet dhe kërcënime ndaj gazetarët gjatë vitit 2018, policia reagoi shpejtë, por nuk mund të thuhet e njëjta edhe për prokurorinë dhe gjykatën. Shembull për reagim të shpejtë kishte në rastin e kërcënimit ndaj kryetari të SHGM-së Naser Selmani.

C.3.2. A janë efikase hetimet e rasteve të frikësimit ose sulmit ndaj gazetarëve?

Analiza e raporteve për mënyrën se si policia dhe prokuroria i zhvillojnë procedura për sulm ose kërcënim ndaj gazetarëve, vërteton se institucionet, jo vetëm që nuk mund ti ndëshkojnë autorët ose nxitësit e sulmeve ndaj gazetarëve, por ata në shumicën e rasteve nuk kanë mundësi as ti identifikojnë e as ti dënojnë dhunuesit. Në raportin veror të vitit 2018, policia pohon se prej 59 sulmeve ndaj gazetarëve në pesë vitet e fundit, 13 sulme nuk janë hetuar fare pasi që hetimi i zyrtarëve policor është zhvilluar në mënyrë joprofesionale, ndërsa në disa raste ka edhe dyshime për shkatërrim të provave.

Institucionet përgjegjëse për zbardhjen e sulmeve ndaj gazetarëve, asnjëherë nuk kanë organizuar trajnime me vetiniciativë për të punësuarit e tyre. Për të kuptuar rëndësinë e mbrojtjes dhe promovimit të lirisë së shprehjes. Me iniciativë të SHGM-së dhe OSBE-së dhe në bashkëpunim me MPB-në dhe Prokurorinë, gjatë vitit 2017, u organizuan një sërë trajnimesh për oficerë të policie, prokurorë dhe gazetarë, me temën e lirisë së shprehjes. Në këto trajnime ishte e dukshme se policët në përgjithësi, kishin shumë pak njohuri për praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në mbrojtje të lirisë së shprehjes.

